



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM / KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS GODIŠNJI IZVEŠTAJ PERFORMANSE ANNUAL PERFORMANCE REPORT

2015

Prishtinë, Prill 2016



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

2015

Prishtinë, prill 2016

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM



Besnik Osmani
Auditor i Përgjithshëm

I nderuar Kryetar, të nderuar deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Pas pranimit të mandatit të Auditorit të Përgjithshëm më 30 mars 2016, jam i lumtur që më jepet mundësia të paraqes Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2015. Ky raport ofron një bazë të mirë informacioni për përmbushjen e mandatit ligjor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe shfrytëzimin e burimeve të saj gjatë vitit.

Raporti vë në pah numrin e madh të produkteve të auditimit, që janë raportet e auditimit të rregullsisë dhe performancës të vitit 2015. Këto raporte i ofrojnë Kuvendit dhe entiteteve të audituara mbështetje praktike në mbylljen e zinxhirit llogaridhënës në mes Qeverisë dhe Kuvendit si dhe tregojnë se ne po e fokusojmë punën tonë gjithnjë e më shumë në ndërtimin e një menaxhimi të shëndoshë financiar. E gjithë puna jonë mbështetet mbi një proces të sigurimit të cilësisë, gjithnjë e më rigoroz dhe ne do të vazhdojmë ta zhvillojmë këtë për të siguruar se po i zbatojmë standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikën e mirë.

Ne besojmë që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm u ka ofruar vlerë autoriteteve publike, të cilat përballen me presione organizative, financiare dhe operative. Ato kanë pasur përkrahje konstruktive përmes auditimeve tona dhe rekomandimeve praktike në raportet tona.

Autoritetet publike janë përgjegjëse për mënyrën se si i përdorin burimet dhe kompetencat publike dhe puna e Auditorit të Përgjithshëm është për të dhënë siguri të pavarur Kuvendit dhe qytetarëve për mënyrën se si paraja publike po shpenzohet dhe si programet qeveritare po realizohen.

Gjatë hartimit të raporteve të auditimit, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka provuar ta vendos veten në pozitën e përdoruesve të informacionit. Nga ky këndvështrim, qëllimi ka qenë të vazhdojmë të punojmë për raportim më të thjeshtë dhe informacion të integruar.

Aktualisht Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është në fazën e rishikimit të strategjisë për të përcaktuar sferat më me interes për publikun dhe për t'i inkorporuar në portfolion e auditimit. Lidhur me këtë po zhvillohen diskutime aktive me stafin e zyrës dhe me shumë partnerë. Megjithatë ne duhet gjithashtu t'i pranojmë sfidat. Niveli i zbatimit të rekomandimeve tona ende nuk është i kënaqshëm. Është e rëndësishme që ne të punojmë me organizatat buxhetore dhe me Kuvendin për të identifikuar dhe adresuar pengesat për zbatimin më efektiv. Kjo, si dhe theksi i vazhdueshëm mbi çështjet e qeverisjes do të jenë fokusi kryesor në vitin e ardhshëm. Megjithatë, unë e pranoj që sfidat që kemi përpara nuk janë të pakta, sepse pritshmëritë nga ne, si auditorë të jashtëm, vazhdojnë të rriten dhe entitetet që ne auditojmë, janë duke u përballur me vështirësi të shumta dhe barriera të ndryshme.

Vizioni ynë është që të bëhemi institucion publik i auditimit të jashtëm i cili në mënyrë të qëndrueshme zbaton plotësisht standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikatat e mira evropiane.

Në fund, unë shpreh respektin për stafin e Zyrës dhe subjektet e audituara që kanë punuar së bashku për qëllimet fisnike të auditimit dhe përmbushjen e obligimeve të ndërsjella.

Pres me padurim që të raportoj mbi këto zhvillime në Raportin Vjetor të Performancës të vitit 2016.

Prishtinë, 30 prill 2016

Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm

TABELA E PËRMBAJTJES

	Fjala e Auditorit të Përgjithshëm.....	1
	Tabela e përmbajtjes	3
	Shkurtime rreth Zap	4
1	Përmbledhje e Performancës.....	5
2	Treguesit e Rezultateve	6
2.1	Mbulimi i Auditimit	6
2.2	Cilësia e Raporteve Tona.....	8
2.3	Ndikimi	9
2.4	Vlerësimi i Jashtëm dhe i Brendshëm	11
3	Burimet.....	13
3.1	Burimet Financiare.....	13
3.2	Pasuritë	16
3.3	Burimet Njerëzore.....	17
4	Bashkëpunimi.....	22
4.1	Projektet.....	22
4.2	Rrjeti.....	23
5	Fokusi i Ardhshëm	24
6	Llogaridhënia e Zap	25
	Shtojcat.....	26
	Shtojca 1: Parathënie e Shkurtër për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.....	26
	Shtojca 2: Numri dhe Lloji i Auditimeve	29
	Shtojca 3: Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2015 dhe Adresimi i Rekomandimeve për vitin 2014 ..	31
	SHTOJCA 4: OPINIONI I AUDITORIT TË JASHTËM PËR VITIN 2015	31

SHKURTIMISHT RRETH ZAP

Vizioni ynë

Zyra Kombëtare e Auditimit është një institucionin suprem i auditimit që ndihmon institucionet e Kosovës në shfrytëzimin racional të parasë publike, në ngritjen e qeverisjes së mirë dhe të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve dhe konsiderohet nga partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë si një institucion me kredibilitet dhe integritet të lartë profesional dhe institucional.

Misioni ynë

Kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar të administratës publike duke kryer auditime cilësore në pajtim me kornizën ligjore dhe standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht si dhe duke aplikuar praktikatat e mira evropiane.

Aktiviteti

Ne auditojmë pasqyrat vjetore financiare të gjitha organizatave buxhetore për të përcaktuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat janë aprovuar dhe kryejmë auditime të performancës me synim përmirësimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre me kosto efektive.

Ne jemi të dedikuar që jo vetëm të ofrojmë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, por edhe të ndihmojmë entitetet tona të audituara që të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit përmes rekomandimeve praktike dhe konstruktive, duke i shtuar kështu vlerë veprimtarive të tyre operative dhe strategjike.

Ne përmes perspektivës sonë të auditimit të jashtëm ndihmojmë Kuvendin që të kërkojë

llogari nga Qeveria.

Ne punojmë ngushtë me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike për të vlerësuar vlerën për para që arrihet përmes shërbimeve publike.

Rezultatet

Rezultatet e punës sonë do të krijojmë besueshmëri në shpenzimin e fondeve publike dhe ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesave të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit përmes rritjes së llogaridhënies publike.

1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS

Ne kemi trajtuar sfidat operative dhe administrative pas përfundimit të kontratës së ish-Auditorit të Përgjithshëm në fund të gushtit 2014. Ne ruajtëm fokusin mbi rezultatet dhe zhvilluam cilësinë në veprimet tona.

Sezoni i auditimit 2014/15 ka përfunduar në fund të gushtit të vitit 2014. Ne raportuam 117 auditime në total:

- Raportin statutor të auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e nëntë raporte statutorë në kuadër të BK-së;
- Njëzet e shtatë auditime jo-statutorë (prej tyre: gjashtëmbëdhjetë auditime të performancës dhe njëmbëdhjetë auditime të fondeve të donatorëve).

Sezoni i auditimit 2015/16 ka filluar në shtator të vitit 2015 dhe planifikojmë të raportojmë 109 auditime:

- Raportin statutor të auditimit të BK-së;
- Nëntëdhjetë raporte statutorë në kuadër të BK-së;
- Tetëmbëdhjetë auditime jo-statutorë (prej tyre: shtatëmbëdhjetë auditime të performancës dhe një auditim të fondeve të donatorëve).

Asistimi në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe MFP-së

- Zhvillimi pozitiv në mbikëqyrjen parlamentare nuk ishte sipas pritjeve për shkak të ngërçit politik në mes të pozitës dhe opozitës. Për shkak të kësaj, ne përqendruam burime shtesë për të përcjellë se si janë adresuar rekomandimet tona të auditimit. Zhvillim pozitiv është vërejtur; dhe
- Konkluzionet tona të auditimit dhe rekomandimet e ndërlydhura kanë mbështetur intervenimet me degën e ekzekutivit dhe projektet e ndryshme në fushën e MFP-së në mënyrë aktive duke krijuar një bazë më të mirë për qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie. Me gjithë progresin e përmendur ne kemi theksuar se duhet të ketë më shumë fokus në maksimizimin e rezultateve dhe arritjen e rezultateve të pasqyruara në vendimmarrje dhe prioritetet politike.

Modernizimi i Qeverisjes korporatave

- Ne kemi përgatitur platformën e re për Auditorin e Përgjithshëm të ri në mënyrë që të mund të prioritetizojë aktivitetet;
- Për sezonin e auditimit 2015/16 është bërë një ri-përshtatje e lehtë e organizatës që të adresohen më mirë kërkesat dhe nevojat për auditim në veçanti të sektorit të qeverisjes lokale;
- I gjithë stafi jonë ka arritur të kuptojë më mirë bazën, kontekstin dhe teknikat e auditimit modern në sektorin publik përmes zbatimit të programit të ri të certifikimit për auditorët e sektorit publik;
- Ne kemi pozicionuar veten si partnerë në forume të bashkëpunimit rajonal në mesin e shteteve kandidate dhe kandidate-potencial. Po ashtu, deri në një masë, marrim pjesë në forume të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe evropian në mesin e Institucioneve Supreme të Auditimit; dhe
- Ne kemi stimuluar profesionalizmin dhe efikasitetin si dhe kemi futur në funksion mjete dhe instrumente reja për të zhvilluar edhe më tej fokusin dhe një qasje të orientuar kah rezultatet.

Llogaridhënia

- Ne kemi dorëzuar Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2014 me kohë dhe është diskutuar nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

2.TREGUESIT E REZULTATEVE

Përmes procesit të auditimit, raporteve të publikuara dhe angazhimeve tjera ne:

- Ndihmojmë Kuvendin e Kosovës që të kërkoj llogaridhënie nga organizatat buxhetore qeveritare dhe institucionet e pavarura për mënyrën se si i shpenzojnë paratë publike;
- Ndihmojmë Asamblatë Komunale dhe qytetarët që të kërkojnë llogaridhënie nga komunat se si i shpenzojnë paratë publike; si dhe
- Ndihmojmë organizatat qendrore dhe lokale në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, të qeverisjes së mirë dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Më poshtë janë përmbledhur rezultatet e aktiviteteve tona të matura përmes treguesve sasior dhe cilësor, të cilët mundësojnë krahasimin ndër vite dhe sezone të auditimit:

2.1 Mbulimi me auditim – aspekti i madhësisë së Buxhetit të Kosovës (BK) që mbulohet me auditimet statutorë dhe numri i raporteve të auditimeve tjera të analizuar;

2.2 Cilësia e auditimeve dhe e raporteve – numri i auditimeve të përfunduara dhe raporteve të publikuara që i nënshtrohen Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë;

2.3 Ndikimi i auditimeve dhe raporteve – numri i takimeve të mbajtura nga KMFP për rishikimin e raporteve tona, nivelin e rekomandimeve tona të adresuara nga entitetet e audituara dhe konkluzionet në opinione të auditimit; dhe

2.4 Vlerësimet e jashtme dhe të brendshme – nga partnerët tanë të jashtëm dhe të brendshëm për performancën tonë organizative dhe besueshmërinë e punës tonë.

2.1MBULIMI I AUDITIMIT

Në përputhje me mandatin tonë ne kryejmë tri lloje të auditimeve:

- Auditime të rregullsisë apo auditime statutorë¹;
- Auditime të performancës apo auditime jo-statutorë²; si dhe
- Auditime të projekteve të donatorëve sipas kërkesës.

Auditime të rregullsisë apo statutorë: përfshijnë auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) të Organizatave Buxhetore (OB-të) si dhe për auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës (RVF/BK-së). Këto auditime kryhen për çdo vit dhe raportohen në një afat të caktuar kohor. Auditimet fillojnë në shtator, memot e auditimit dorëzohen në dhjetor ndërsa raportet për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Derisa cikli i auditimit përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës (RVF/BK-së) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës pastaj në shtator fillon cikli i ri i auditimit.

Auditime të performancës apo jo-statutorë: përfshijnë auditimin e temave të ndryshme në fushën e prokurimit, shërbimeve të ofruara për qytetarët si dhe zhvillimit të tregut privat. Këto janë auditime diskrecionale dhe ato nuk ndërlidhen me një afat të caktuar kohor. Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, kapacitetet ekzistuese si dhe në kriteret tjera përkatëse.

¹ Auditimet e rregullsisë janë auditime statutorë të obliguara me ligj. Ato e përfshinë auditimin e pasqyrave vjetore financiare, pajtueshmërinë me kornizën e aplikueshme, qeverisjen si dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin.

² Auditime jo-statutorë përfshijnë auditime të performancës, auditime menaxheriale ose auditime të sistemit dhe nuk kanë kufizime ligjore për dorëzimin e tyre kohor.

Auditime të projekteve të donatorëve: përfshijnë auditimin e fondeve të donatorëve të dhëna OB-ve. Këto auditime kryhen me pagesë në bazë të marrëveshjeve me donatorët dhe/ose përfituesit e tyre.

Përmes auditimeve dhe aktiviteteve tjera këshilluese ne e mbështesim llogaridhënien dhe transparencën e organizatave të audituara në përdorimin e parasë publike, pajtueshmërinë me kërkesat ligjore, qeverisjen e mirë, arritjen e vlerës për para si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Derisa auditimet e projekteve të donatorëve e hapin rrugën për më shumë përkrahje të drejtpërdrejt buxhetore.

Numri dhe lloji i raporteve të auditimit

Deri në fund të vitit 2015, ne kemi përfunduar dhe publikuar me kohë:

- Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2014;
- 89 raporte të auditimit të rregullsisë për PVF-të e vitit 2014;
- 90 memo të auditimit të rregullsisë për vitin 2015. Raportet do publikohen në vitin 2016;
- 11 raporte të auditimit për projektet e donatorëve;
- 15 raporte të auditimit të performancës ; ndërsa
- 17 auditime tjera të performancës dhe një auditim i donatorëve janë në proces. Raportet nga këto auditime do të publikohen në vitin 2016

Me kërkesë të Kuvendit, në muajin Maj të vitit 2015, Auditori i Përgjithshëm në detyrë ka prezantuar në seancë plenare RVA të RVF/BK për vitin 2013. RVA/BK për vitin 2014 është dorëzuar në Kuvend në fund të gushtit të vitit 2015. Ky raport, në tetor të vitit 2015, është prezantuar para Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i cili ka përgatitur një listë rekomandimesh për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës. Por, ky raport nuk është vu në rend dite të seancës plenare.

Në këtë mënyrë, përmes auditimit të rregullsisë kemi arritur ti mbulojmë të gjitha auditimet statutoare të OB-ve me përjashtim të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Përveç kësaj, me kohën dhe stafin e limituar kemi mbuluar një numër të konsiderueshëm të auditimit të performancës dhe të projekteve të donatorëve me fokus në disa prej fushave të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Numri i auditimeve të rregullsisë si dhe të performancës është duke u rritur në mënyre progresive përgjatë viteve. Ndërsa numri i auditimeve të projekteve të donatorëve në sezonin e fundit ka rënë dhe kjo e reflekton përfundimin e marrëveshjeve me donatorët. Sidoqoftë, ne presim të auditojmë më shumë projekte të donatorëve në të ardhmen.

Tabela 1 tregon portfolion tonë të përgjithshme të auditimit, përfshirë numrin dhe llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për tre vitet e fundit. Për më shumë detaje rreth raporteve të përfunduara dhe të auditimeve në proces referohuni Shtojcës 2.

Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara dhe të kryera gjatë sezoneve

Llojet e Auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit
	2015/2016	2014/2015	2013/2014
Auditimi Statutor	91	90	89
- BK	1	1	1
- Autoritetet Shtetërore	24	24	24
- Komunat	38	38	38
- Të kontraktuara	- 6 ³	-6	- 11
- Institucionet e pavarura	28	27	26
Jashtë BK-së	0	0	0
Auditimi jo-statutor	18	27	13
- Auditimet e Performancës	17	16	9
- Auditimi i fondeve të donatorëve	1	11	4
Gjithsej	109	117	102

Në nivel të qeverisjes lokale, ne kemi vazhduar kontraktimin e punës tonë tek firmat private të auditimit në komuna edhe pse numri i auditimeve të kontraktuara është zvogëluar në gjashtë. Kjo na mundëson të krahasojmë cilësinë e auditimeve tona me atë të sektorit privat.

2.2 CILËSIA E RAPORTEVE TONA

Cilësia në auditim përcaktohet nga:

- rëndësia e çështjeve që auditohen
- objektiviteti dhe efikasiteti i procesit; si dhe
- qartësia dhe besueshmëria e raporteve dhe ndikimi i tyre.

Arritja dhe ruajtja e cilësisë së lartë përgjatë procesit të auditimit mbetet një ndër prioritetet tona kryesore. Për të siguruar këtë ne aplikojmë një qasje sistematike në nivel të organizatës.

Në këtë kontekst, i kemi të adoptuar parimet dhe standardet e auditimit të Organizatave Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Kodi jonë i etikës dhe i mirësjelljes profesionale rregullon kredibilitetin, integritetin, objektivitetin, paanshmërinë si dhe konfliktin e interesit. Përmes procesit të certifikimit për auditorët e rregullsisë dhe të performancës si dhe trajnimeve teorike dhe praktike kemi promovuar edukim të vazhdueshëm profesional.

Manualet tona të auditimit dhe udhëzuesi për menaxhimin e cilësisë e përcaktojnë standardin e cilësisë dhe procedurat që duhet ndjekur për kontrollin e saj. Për të siguruar nëse procedurat e kontrollit të cilësisë zbatohen në mënyrë efektive kemi vendosur mekanizma të veçantë për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë. Këto së bashku e përbëjnë sistemin tonë të menaxhimit të cilësisë (SMC).

Edhe gjatë vitit 2015, kemi marrë përkrahje nga partnerët ndërkombëtarë⁴ në zhvillimin dhe aplikimin efektiv të SMC-së. Zyra Kombëtare e Auditimit e Mbretërisë së Bashkuar ka mbështetur auditimet e rregullsisë ndërsa Gjykata Holandeze e Auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë dhe projekti i Bankës Botërore kanë mbështetur auditimet e performancës.

³ Në nivel të qeverisjes lokale, ne kemi kontratë më kompanitë private të auditimit për mbulimin e auditimit në gjashtë komuna.

⁴ Bashkëpunimi i ZAP-së me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar dhe me Gjykatën Holandeze të Auditimit është zhvilluar në kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së. Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë po zhvillohet në kuadër të një marrëveshje bilaterale. Bashkëpunimi me dy këshilltarë ndërkombëtar është zhvilluar në kuadër të një projekti të Bankës Botërore për zhvillimin e auditimit të vlerës së parasë në prokurim.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë

Në përputhje me sistemin tonë të menaxhimit të cilësisë (SMC) ne kryejmë:

- Kontrollin e cilësisë;
- Monitorimin e cilësisë; si dhe
- Sigurimin e cilësisë.

Kontrolli i cilësisë: është tërësia e procedurave të cilat aplikohen gjatë procesit të auditimit për të siguruar punë të cilësisë së lartë. Kontrolli i cilësisë aplikohet në çdo auditim.

Për këtë, ne kemi siguruar udhëheqje, mbikëqyrje dhe rishikim efektiv në të gjitha fazat e auditimit përfshirë planifikimin, ekzekutimin, raportimin si dhe përcjelljen e rekomandimeve. Gjithashtu kemi specifikuar rolet dhe përgjegjësit e secilit pjesëmarrës për çdo fazë të auditimit.

Monitorimi i cilësisë: është një formë e rishikimit të brendshëm që ka për qëllim të siguroj nëse procedurat e kontrollit të cilësisë funksionojnë në mënyrë efektive. Monitorimi bëhet nga auditorët e departamentit për mbështetje në auditim të cilët janë të pavarur nga auditimi nën monitorim.

Sigurimi i cilësisë: është një formë e rishikimit të pavarur i cili kryhet pas përfundimit të auditimit. Sigurimi i cilësisë mund të bëhet nga vet auditorët e ZAP-së ose nga Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve tjera apo edhe nga ekspertët e jashtëm të organizatave relevante profesionale. Ky rishikim bëhet në periudha periodike më të gjata se një vjeçare.

Deri në fund të vitit 2015, ne kemi bërë:

- Kontrollin e cilësisë në të gjitha auditimet e zhvilluara;
- Monitorimin e cilësisë në 16 auditime të rregullsisë për PVF-të të vitit 2014.
- Sigurimin e cilësisë në shtatë auditime të rregullsisë për PVF-të të vitit 2014. Kjo është bërë nga auditorët e DMA-së brenda ZAP-së; si dhe
- Monitorimin e cilësisë së planifikimit në 17 auditime të rregullsisë për PVF-të vitit 2015.

Përveç kësaj, partnerët tanë ndërkombëtar kanë mentoruar gjithsej 28 auditime. Prej tyre, tetë auditime të rregullsisë dhe 20 të performancës përfshirë auditimin paralel të zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit rajonal.

Aktivitetet e lartpërmendura të menaxhimit të cilësisë janë aplikuar ndaj të gjitha auditimeve të zhvilluara. Konkluzionet dhe rekomandimet e dalura prej tyre na kanë shërbyer si bazë për ngritjen e cilësisë në ciklet e ardhshme të auditimit. Në këtë mënyrë, cilësia e përgjithshme e punës dhe e produkteve tona është përafruar me kërkesat e SNA-së të ISA-ve dhe praktikat e mira evropiane megjithëse ende ka për tu bërë.

Në tërësi, jemi duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së punës sonë dhe raporteve të hartuara. Ne jemi të vetëdijshëm për nevojën e ngritjes së mëtejme të cilësisë. Prandaj, çdo vit bazuar në mësimet e nxjerra dhe reagimet e marra, ne kemi bërë ndryshime pozitive në mënyrën se si janë kryer auditimet dhe se si janë raportuar rezultatet. Ne jemi të përkushtuar në konsolidimin e auditimeve tona statutove si dhe në zhvillimin e cilësisë dhe të fushëveprimit të auditimeve jo-statutove. Ndërsa partnerët tanë vazhdojnë të na ndihmojnë në arritjen e këtyre objektivave.

2.3 NDIKIMI

Ndikimi i auditimit pasqyrohet me kursimet dhe përmirësimet në sistemin e menaxhimit të financave publike dhe të performancës së përgjithshme në nivele të ndryshme të qeverisjes.

Arritja e ndryshimeve pozitive tek organizatat e audituara është qëllimi ynë primar. Për këtë, ne i kushtojmë vëmendje të posaçme ndikimit dhe efektit të auditimeve tona, të raporteve të hartuara dhe të angazhimeve tjera.

Në raportet tona gjatë vitit 2015 ne i kemi dhënë rëndësi të veçantë Qeverisjes së mirë duke identifikuar praktika të mira dhe duke i shpërndarë ato me organizata tjera të sektorit publik.

Gjatë vitit 2015, ne gjithashtu kemi përkrahur komisionin e Kuvendit dhe grupet punuese ndërqeveritare, kemi bashkëpunuar me agjencitë mbikëqyrëse si dhe ju kemi dhënë mbështetje të drejtpërdrejt organizatave të audituara

Përkrahja e Kuvendit dhe pjesëmarrja në grupet punuese:

- Kemi përkrahur Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendit të Kosovës në shqyrtimin e 16 raporteve tona të auditimit⁵. Numri i dëgjimeve publike në 2015 ishte dukshëm më i madh krahasuar me vitet paraprake⁶. Gjithashtu në një seancë të veçantë janë diskutuar raportet e auditimit për komunat; si dhe
- Kemi marrë pjesë aktive në komitetin drejtues për kontrolle të brendshme të financave publike (KBFP), në grupin punues për strategjinë kombëtare për zhvillim ekonomik, për strategjinë për KBFP si dhe për strategjinë dhe ndryshimet e ligjit për prokurimin publik.

Përkrahje e drejtpërdrejt për organizatat e audituara:

- Kemi identifikuar mundësi dhe rekomanduar veprime konkrete për kursime në procesin e furnizimit me libra shkollor dhe në menaxhimin e skemave pensionale dhe sociale;
- Kemi kontribuar në përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor të subvencioneve në Bujqësi si dhe në nxjerrjen udhëzimeve/kritereve specifike për shpërndarjen e tyre;
- Kemi kontribuar në evidentimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor;
- Kemi ndihmuar thesarin në përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare si dhe në analizimin e pagesës së faturave të OB-ve sipas vendimeve gjyqësore;
- Kemi ndihmuar në kthimin e pagesave të parregullta në Ministrinë e Shëndetësisë (një rast kur mjekët kanë kthyer pjesë të pagesave të parregullta në QKUK dhe një rast tjetër kur palët kontraktuese janë obliguar ti kthejnë fitimet e parregullta në Ministri);
- Kemi promovuar zbatimin më të mirë dhe më efikas të kërkesave të legjislacionit në fushën e prokurimit dhe financave publike; si dhe
- Kemi nxitur diskutime të gjëra rreth konceptit të qeverisjes së mirë dhe qasjes ndaj menaxhimit të rrezikut, etj.

Bashkëpunimi me organizatat mbikëqyrëse:

- Kemi bashkëpunuar me Agjencinë kundër korrupsionit dhe me institucionet tjera relevante në ofrimin e informatave dhe sqarimeve lidhur me rastet potenciale për hetim.

Numri dhe përqindja e rekomandimeve të implementuara

Auditimet tona të rregullsisë kanë rezultuar me rekomandime për organizatat e audituara për përmirësimin e raportimit financiar, qeverisjes së mirë dhe të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve. Derisa auditimet e performancës kanë rezultuar me rekomandime për përmirësimin e shërbimeve publike me fokus në çështjet e strategjike si dhe në arritjen e vlerës më të mirë për paranë e shpenzuar. Ne në vazhdimësi e përcjellim progresin e implementimit të rekomandimeve. Në raportet e auditimit të vitit 2015 kemi raportuar për gjendjen e rekomandimeve të dhëna një vit më parë. Rezultatet nga përcjellja/dhe analizimi i progresit në implementimin e rekomandimeve i kemi përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

⁵ Gjatë vitit 2015, KMFP ka shqyrtuar 12 raporte të auditimit të rregullsisë, 4 raporte të performancës si dhe Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2014

⁶ Në vitin 2014, KMFP kishte shqyrtuar dy raporte të auditimit, derisa një vit më herët 16 raporte.

Tabela 2: Shkalla e adresimit të rekomandimeve të mëhershme

Subjektet e audituara	Rrekomandimet e dhëna	Të implementuara		Të adresuara (në process)		Të pa adresuara	
	Nr	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet Qendrore	313	98	31	95	30	120	39
Institucionet e pavarura	199	102	51	37	19	60	30
Komunat	521	136	26	172	33	213	41
Totali	1033	336	32	304	29	393	37

Implementimi i rekomandimeve nga institucionet e nivelit qendror është më i ulët në krahasim me vitin paraprak. Një ndër shkaqet për këtë është vakumi politik i krijuar pas mbajtjes së zgjedhjeve. Ndërsa implementimi i rekomandimeve nga institucionet e pavarura dhe nga komunat është i ngjashëm me vitet paraprake.

Gjithashtu, kemi vlerësuar implementimin e rekomandimeve të RVA-së të dhëna për Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe për Kuvendet Komunale. Implementimi i tyre është i ulët dhe disa janë përsëritur nëpër vite (për më tepër referojuni Raportit Vjetor të Auditimit për 2014).

Përveç rekomandimeve të lartpërmendura, kemi dhëna këshilla përmes memorandumeve të ndërmjetme për përmirësimin e kontroleve të brendshme dhe raportimin e financiar. Si rezultat, PVF-të OB-ve ishin të cilësisë më të mirë për dallim nga pasqyrat financiar nëntë-mujore.

2.4 VLERËSIMI I JASHTËM DHE I BRENDSHËM

Gjatë vitit 2015, aktivitetet tona ishin subjekt i vlerësimit të disa institucioneve. Vlerësimet e jashtme të bëra nga BE, PEFA, SIGMA tregojnë për një zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve organizative dhe funksionale të ZAP. Krahas progresit të arritur, ato konfirmojnë sfida të caktuara dhe nevojën për adresimin e tyre. Në mesin e tyre janë përzgjedhja e auditorit të përgjithshëm⁷, forcimi i pavarësisë profesionale përmes aprovimi i ligjit të ri për Zyrën Kombëtare të Auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira evropiane. Gjithashtu duhet të vazhdoj zhvillimi i mëtutjeshëm i auditimit të performancës si dhe konsolidimi i auditimit të rregullsisë në përputhje me trendët dhe zhvillimet e profesionit të auditimit të sektorit publik.

Fushat e identifikuara për përmirësim nga këto vlerësime do të jenë bazë për zhvillimin dhe caktimin e prioriteteve tona në të ardhmen.

Disa nga konkludimet e KE në raportin e Progresit për vitin 2015 janë:

"ZAP ka përmirësuar cilësinë e auditimit duke miratuar manualet e auditimit në harmoni me standardet e Organizatave Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme (ONISA) të auditimit gjatë viteve të kaluara. Ajo në vazhdimësi i përditëson këto manuale në baza vjetore, që të jenë në harmoni me standardet e ONISA-s. Ekziston një kornizë e menaxhimit të cilësisë.

⁷ Çështje që tanimë është adresuar.

...Ndikimi i auditimit duhet të përmirësohet më tutje. Raporti vjetor i Auditimit diskutohet nga Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike, por mungon një përcjellje sistematike nga Parlamenti për raportin e auditimit".

Rivlerësimi i shpenzimeve publike dhe llogaridhënies financiare (PEFA, 31 janar 2016) thekson

"performanca është përmirësuar nën PI-26 (auditimi i jashtëm) për shkak të një rritje prej 100% të auditimit të shpenzimeve të OB-ve. Gjithnjë e më tepër po kryhen auditime të performancës. Rekomandimet e auditimeve të ZAP-së po zbatohen deri në një masë, mirëpo ende nuk ka ndonjë mekanizëm formal për sigurim të zbatimit".

"Seksioni 2 i ligjit për ZAP, ofron diskrecion të plotë dhe pavarësi të Auditorit të Përgjithshëm në ushtrimin e funksioneve të tij/saj. Mirëpo, Auditori i Përgjithshëm ende nuk është financiarisht i pavarur prej degës ekzekutive të qeverisë, shkelje e një prej standardeve të auditimit të caktuara nga Organizata ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

"...Përderisa ZAP-i e përcjell implementimin e rekomandimeve, nuk ka asnjë mekanizëm se qeveria i zbaton Ato...

Një tjetër vlerësimin i bërë nga SIGMA konkludon:

"Ligji për ZAP i vitit 2008, nuk është plotësisht në harmoni me SNISA-të dhe si i tillë nuk e rregullon pavarësinë dhe organizimin e ZAP. Ligji i ri është në fazën e fundit të përgatitjes dhe rregullon qartë pavarësinë funksionale, operacionale dhe financiare, mandatin e Auditorit të Përgjithshëm si dhe organizimin e ZAP; gjithashtu mbron pozitën e AP. Menaxhmenti i ZAP-it ka ndërmarrë hapa për të zhvilluar ZAP në një institucion të respektuar, profesional suprem të auditimit.

Pasi që kërkesa themelore për pavarësinë, mandatin dhe organizimin e një ISA-i, ende nuk është në përputhje me SNISA -të, ky tregues nuk u vlerësua maksimalisht.

"...Metodologjia e auditimit është në pajtim me standardet ndërkombëtare të e auditimit. Por megjithatë, në praktikë kjo metodologji nuk përdoret ashtu që të ofroj auditime dhe rekomandime të cilësisë së lartë".

Rekomandimet kryesore për ZAP, që dalin nga ky vlerësim janë: aprovimi i ligjit të ri nga qeveria, zhvillimi dhe adoptimi i Strategjisë 2014-2020 si dhe përmirësimi i cilësisë së auditimit të rregullsisë dhe performancës.

Gjatë vitit 2015 ZAP iu nënshtrua edhe një vlerësimi gjithëpërfshirës të sistemit të integritetit kombëtar nga KDI në bashkëpunim me Transparency International Berlin. Raporti i referohet ZAP-it si një institucion rol-model i suksesshëm për institucionet tjera sa i përket integritetit dhe një potenciali për luftimin e korrupsionit në administratë dhe si e tillë ZAP ishte një nga institucionet me notimin më të lartë në vlerësim.

Për më tepër, ky raport rekomandon: krijimin e mekanizmave formal të bashkëpunimit me prokurorinë dhe njësinë e policisë për krime ekonomike dhe korrupsion, rritjen e numrit të auditimeve të performancës dhe ndryshimi i ligjit për ZAP.

Përveç kësaj, në konferencën vjetore ne marrim pikëpamjet nga stafi jonë si një input i rëndësishëm për vlerësimin e aktiviteteve tona, identifikimin e sfidave dhe mundësive për përmirësim. Më shumë për vlerësimet e brendshme mund të gjeni te pika 2.2 Cilësia e raporteve tona.

3. BURIMET

Burimi kryesor i financimit të aktiviteteve dhe stafit të ZAP vazhdon të mbetet Buxheti i Kosovës.

Në numrin aktual të stafit gjatë vitit 2015 nuk janë të përfshirë pozita e Auditorit të Përgjithshëm dhe u.d. Drejtorit të Përgjithshëm.

Auditori i Përgjithshëm është emëruar në tremujorin e parë të vitit 2016 nga Kuvendi përderisa posti i Drejtorit të Përgjithshëm ka vazhduar angazhim me kontratë për shërbime deri në adoptim të ligjit të ri.

Gjatë vitit 2015, ZAP ka pranuar donacione nga partnerët ndërkombëtarë për ta mbështetur strategjinë tonë zhvillimore si dhe janë krijuar të hyra të kufizuara nga auditimi i projekteve të financuara nga donatorët.

3.1 BURIMET FINANCIARE

Buxheti fillestar i aprovuar me Ligjin e Buxhetit Nr. 05/L-001 për vitin 2015 ishte në vlerën 2,212,515€.

Gjatë vitit në buxhetin fillestar kanë ndodhur këto ndryshime:

- Paga dhe mëditje: Shuma e aprovuar në fillim të vitit ishte 1,573,740€, derisa me Ligjin nr. 05/L-046 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të Buxhetit është ndarë edhe një buxhet shtesë prej 1,775€. Në fund të vitit buxheti i shpenzuar ishte në vlerën 1,613,332€. Diferenca mes buxhetit të aprovuar dhe atij të shpenzuar është si rezultat i fillimit të implementimit të vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 06/29, me të cilin nga Maji i vitit 2015 ka filluar pagesa shtesë mbi përvojën e punës për të gjithë shërbyesit civil. Dallimi në vlerë prej 37,817€ është alokuar nga Ministria e Financave – kontigjenca për paga.
- Mallrat dhe Shërbimet: Shuma e aprovuar ishte 604,775€.

Ndryshimet prej buxhetit fillestar janë si në vijim:

- a) Me Ligjin nr. 05/L-046 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të Buxhetit, buxheti për mallra dhe shërbime u zvogëlua për 53,486€,
- b) Me vendimin e datës 23.12.2015, nr. 09/65 të Qeverisë së Kosovës, buxheti për mallra dhe shërbime u zvogëlua për 23,661€; dhe
- c) Donacionet nga partnerët tanë në vlerë prej 66,294€ janë transferuar në këtë kategori.

Buxheti final në këtë kategori ekonomike në fund të vitit ishte 593,922€.

- Shërbime komunale: Shuma e aprovuar ishte 34,000€. Me vendimin e datës 23.12.2015, nr.09/65 të Qeverisë së Kosovës kjo ndarje buxhetore është zvogëluar për 7,333€.
- Investimet kapitale: Shuma e aprovuar ishte zero.

Donacionet:

- a) Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë ka ndarë donacion prej 15,815€:
 1. 10,000€ për të financuar këshilltarin e u.d. Auditorit të Përgjithshëm në finalizimin e sezonit të auditimit 2014-2015 si dhe për planifikimin e sezonës së ardhshëm 2015-2016; dhe
 2. 5,815€ për të financuar këshilltarin e auditimit për mbështetje dhe mentorim të ekepeve të auditimit në divizionin e auditimit të rregullsisë.
- b) Ambasada Norvegjeze në Kosovë ka ndarë donacion prej 9,975€ për të financuar këshilltarin e u.d. Auditorit të Përgjithshëm në finalizimin e sezonit të auditimit 2014-2015 si dhe për planifikimin e sezonës së ardhshëm 2015-2016; dhe
- c) Banka Botërore ka ndarë donacion prej 40,505€ për financimin e projektit "Zhvillimi i aftësive profesionale në auditimin e vlerës për para në sistemet e prokurimit" i cili ka filluar në vitin 2014.

Të hyrat tjera:

Shuma prej 10,757€ përfaqëson vlerën e të hyrave të gjeneruara nga auditimet e projekteve të donatorëve të financuara nga TAMAD dhe UN Habitat. Këto të hyra janë depozituar direkt në llogarinë e Buxhetit të Kosovës dhe nuk janë përdorur nga ne.

Pas këtyre ndryshimeve, buxheti ynë final në fund të vitit 2015 ishte 2,233,919€.


Tabela 3: Menaxhimi i buxhetit përgjatë tri viteve 2013-2015 (në EUR `000)

Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti final	Buxheti i shpenzuar	Përqindja %
2015				
Buxheti i përgjithshëm	2,213	2,234	2,203	99 %
Pagat dhe Mëditjet	1,574	1,613	1,613	100 %
Mallrat dhe Shërbimet	605	594	564	95 %
Shërbimet komunale	34	27	26	97 %
Transfere dhe subvencione	-	-	-	-
Investimet Kapitale	0	0	0	0 %
2014				
Buxheti i përgjithshëm	2,131	2,210	2,169	98%
Pagat dhe Mëditjet	1,349	1,480	1,480	100%
Mallrat dhe Shërbimet	712	666	644	97%
Shërbimet komunale	40	34	27	80%
Transfere dhe subvencione	-	-	-	-
Investimet Kapitale	30	30	18	59%
2013				
Buxheti i përgjithshëm	2,120	2,121	2,006	95%
Pagat dhe Mëditjet	1,305	1,285	1,268	99 %
Mallrat dhe Shërbimet	620	666	614	92 %
Shërbimet komunale	45	45	29	64 %
Transfere dhe subvencione	100	75	75	100 %
Investimet Kapitale	50	50	20	41 %

Buxheti ynë i aprovuar për vitin 2015 është për 1.1% më i lartë krahasuar me vitin 2014, derisa buxheti i vitit 2014 ishte për 4.2% më i lartë se sa i vitit 2013. Këto rritje reflektojnë kosto më të larta për stafin.


Grafiku 1. Shpenzimet buxhetore nëpër kategoritë ekonomike

SHPENZIMET NEPER KATEGORI EKONOMIKE



Grafiku 2. Shpenzimet buxhetore në kategorinë Mallra e Shërbime

SHPENZIMET NE MALLRA DHE SHERBIME




Nga grafiku nr. 2 vërejmë që sikurse edhe viteve të kaluara qiraja për zyrat mbetet kostoja më e lartë e shpenzuar gjatë vitit 2015.

Pas saj:

- 19% e shpenzimeve ka të bëjë me pagesat për kontraktimin e auditimeve të komunave si dhe pagesat e financuara nga donatorët tanë për zhvillim të mëtutjeshëm të zyrës (Banka Botërore, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë dhe Ambasada Norvegjeze në Kosovë);
- 15 % e shpenzimeve ka të bëjë me pagesat për udhëtimet brenda dhe jashtë vendit. Këto shpenzime kanë ndodhur si rezultat i rritjes së numrit të auditimeve të performancës në Komunitet të cilat janë 50km larg Prishtinës, ngritjes së bashkëpunimi të Institucionit tonë në nivel ndërkombëtar si dhe pjesëmarrjes së stafit në punëtori dhe konferenca jashtë Kosovës; si dhe
- 11% e shpenzimeve që ka të bëjë me pagesat për blerje të pajisjeve të TI dhe furnizime për zyre.

Grafiku 3. Shpenzimet nëpër kategori / krahasuar me buxhetin e shpenzuar

TRENDI I SHPENZIMEVE NËPËR VITE



Nga grafiku nr. 3 mund të vërehet se trendi i shpenzimeve në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ka shënuar rritje nëpër vite. Kjo ka ndodhur si shkak i fillimit të implementimit të dy vendimeve të Qeverisë së Kosovës:

- a) Nga Prilli i vitit 2014 ka filluar të implementohet vendimi i Qeverisë së Kosovës për ngritje të pagave për të gjithë shërbyesit civil në nivelin 25%; dhe
- b) Nga Maji i vitit 2015 ka filluar të implementohet vendimi i Qeverisë së Kosovës për pagesa shtesë mbi përvojën e punës për të gjithë shërbyesit civil.

Krahasuar me këtë, trendi i shpenzimeve në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve nëpër vite ka shënuar ulje duke minimizuar kostot.

3.2 PASURITË

Sikurse vitet e kaluara edhe këtë vit vlera e pasurive tona ishte në rënie. Mundësia për investime të reja kapitale për të përmbushur kërkesat e reja teknologjike ka qenë e kufizuar. Mjete të reja të TI-së dhe zgjidhjet që kontribuojnë në auditim më efikas dhe mbështetje të auditim është dashur të ri-profilizohen për vitet e ardhshme buxhetore.

Vlera e pasurisë kapitale ishte 84,000€ në fund të vitit 2013, 69,000€ në fund të vitit 2014 dhe rreth 41,000€ në fund të vitit 2015. Vlera e pasurive tona jo-kapitale ishte 101,000€, respektivisht 97,000€ dhe 76,000€.

Të gjitha automjetet tona që janë ende në përdorim kanë pasur vlerë neto zero që nga viti 2013.

Gjatë këtij viti është bërë edhe identifikimi i një pjese të pasurisë së dëmtuar e cila si e tillë është jashtë përdorimit të mëtutjeshëm.

Duke pasur parasysh që kjo pasuri për çdo vit dëmtohej edhe më tepër nga amortizimi kohor dhe në të njëjtën kohë merrte një hapësirë të konsiderueshme në objektin tonë është vendosur të jepet donacion institucioneve publike të cilat në mungesë të buxhetit për të siguruar inventar të ri me një investim të vogël do të mund ta vënë në përdorim këtë inventar.

Bazuar në këtë, gjatë vitit 2015 ZAP ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimit me institucionet e listuara më poshtë ku janë specifikuar kushtet dhe sasia e pasurisë së dhënë donacion tek të njëjtat.

Tabela 4: Institucionet përfituese të donacioneve nga ZAP 2015

1. Shkolla fillore e mesme e ulët "28 Nëntori" - Dragash
2. Klinika e Anestezionit dhe Mjekimit Intensiv – Prishtinë
3. Qendra burimore për mësim dhe këshillim "Përparimi" - Prishtinë
4. Qendra Kombëtare e Kosovës për transfuzion të gjakut - Prishtinë
5. Shkolla fillore e mesme e ulët "Jahë Hasani" – Bërvenik
6. Shkolla fillore e mesme e ulët "Zejnel Salihu" – Bardh i Madh
7. Shkolla fillore e mesme e lartë "Shtjefan Gjeqovi"- Prishtinë
8. Shkolla fillore e mesme e ulët "Faik Konica"- Prishtinë

3.3 BURIMET NJERËZORE

Investimi në zhvillimin e personelit për të ofruar shërbime cilësore të auditimit është një prioritet i vazhdueshëm i ZAP-it. Andaj, qëllimi ynë është që përmes zhvillimit të kapaciteteve njerëzore të mbajmë cilësinë e punës sonë në nivelin e pritjeve ndaj atyre të cilëve ju shërbejmë, qytetarëve. Kjo përfshinë edhe sigurimin dhe ofrimin e një mjedisi përkrahës dhe bashkëpunues përmes qasjeve më të avancuara menaxheriale.

Gjatë vitit 2015, ne kemi pas gjithsejtë 150 punonjës që përfshinë nivelin e lartë drejtues, auditorët dhe personeli tjetër profesional dhe administrativ. Në këtë kuadër, ne kemi angazhuar gjashtë zëvendësues për të na ndihmuar në misionin tonë, duke zëvendësuar personelin i cili gjendet në pushim të lehonisë.

Ky sezon i auditimit, me të gjitha sfidat e saj, është kryer me sukses nën udhëheqjen e Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm, i cili në mungesë të Auditorit të Përgjithshëm ka shërbyer si Auditor i Përgjithshëm në detyrë. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, ne kemi angazhuar edhe dy punonjës me marrëveshje për shërbime të veçanta, njëri në cilësinë e Ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, dhe tjetri, si Ekspert i Teknologjisë Informative në Auditim.

Statistikat rreth personelit përgjatë viteve mund t'i shihni në tabelën si më poshtë.

Tabela 5: Personeli nëpër vite

Viti	Tavani personelit	Numri i personelit nga komunitetet	Perqindja e femrave	Mosha mesatare	Numri i udhëheqësve të ekipit	% Levizja e personelit	Pervoja ne zyre me e gjate se dy vite
2013	140	6	47.9%	37.1	38	3.75%	127
2014	146	6	48.9%	38.1	43	1.36	137
2015	146	5	49.3%	37.9	42	1.36 ⁸	138

Numri i udhëheqësve të ekipeve është relativisht i njëjtë me atë të vitit të kaluar, kështu duke plotësuar nevojat tona për të kryer më shumë auditime, e sidomos të performancës.

⁸ Një është pensionuar dhe një ka dhënë dorëheqje.

Sa i përket, plotësimit të kuotës prej 10% të personelit nga komunitetet jo-shumicë, Strategjia e Burimeve Njerëzore 2015 -2020 parasheh masat për rekrutimin, zhvillimin dhe rritjen e këtij numri në përqindjen e kërkuar me Ligjin për Shërbimin Civil në Kosovë. Aktualisht, kjo përqindje është nën nivelin e dëshiruar, pasi që interesi për pozitat e shpallura nga kjo kategori është shumë i vogël. Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona që këtë numër ta rrisim në proceset tona të ardhshme.

Ne kemi vazhduar përpjekjet tona, për mbajtjen e një barazie të mirë gjinore në institucionin tonë. Këtu qëndrojmë mjaft mirë dhe shërbejmë si model në ofrimin e mundësive për të dy gjinitë. Numri i femrave në pozita drejtuese është mjaft i kënaqshëm duke marr parasysh edhe nivelin e pozitave udhëheqëse në auditim.

Tabela më poshtë paraqet një pasqyrë të pozitave udhëheqëse në zyrën tonë. Këtu përfshihen nivelet e larta drejtuese, niveli i mesëm drejtues, pozitat e udhëheqësve të ekipeve të auditimit, si dhe udhëheqësit e njësive profesionale – administrative

Tabela 6: Pozitat drejtuese sipas gjinisë në të gjitha funksionet

Viti	Numri i drejtore ve (femra)	Përqindja %	Numri i drejtore ve (meshkuj)	Përqindja %	Numri i pergjiths hem i femrave ne pozita udheheq ese	Përqindja %	Numri i pergjiths hem i meshkuj ve ne pozita udheheq ese	Përqindja %
2013	6	37.5	10	62.5	23	38.3	37	61.7
2014	7	43.8	9	56.2	26	40	39	60
2015	7	41.2	10	58.8	28	43.1	37	56.9

Korniza jonë e kompetencës luan rol të rëndësishëm në kryerjen e punëve sipas standardeve profesionale të punës dhe atyre ndërkombëtare të auditimit. Kjo kornizë e kompetencës na obligon që gjatë kryerjes së punës të përdorim:

- Aftësitë;
- Zotimin;
- Komunikimin;
- Mirëkuptimin;
- Konkureshmërinë;
- Guximin; dhe
- Kureshtjen.

Këtotribute përforcojnë nevojën që ka i gjithë personeli ynë për tu përmirësuar dhe zhvilluar individualisht dhe kolektivisht. Kjo është në kontekst të njohjes dhe adresimit të sfidave me të cilat ballafaqohemi si institucion që jemi në zhvillim e sipër dhe që punojmë në një mjedis dinamik dhe sfidues.

Ne kemi arritur që përveç punëve të auditimit të ndihmojmë Qeverinë edhe në fusha tjera e në veçanti në shqyrtimin e shumë projektligjeve, me pjesëmarrjen tonë nëpër komisione profesionale dhe dhënien e komenteve për pasurimin e tyre të mëtejshëm.

Kemi raportuar rregullisht, në baza periodike për çështjet që ndërlidhen me personelin dhe pagat, si dhe kemi vazhduar komunikimin tonë edhe me institucionet e pavarura. Në muajin Maj, Qeveria ka filluar të aplikojë shtesat për përvojë në punë prej 0.5% dhe i gjithë stafi kanë përfituar dhe vazhdojnë të pranojnë këtë lloj të shtesës.

Tabela 7: Kategoritë e personelit (në pozitë në fund të vitit)

Kategoria	2015		2014		2013	
	Shifra aktuale	Pozitat	Shifra aktuale	Pozitat	Shifra aktuale	Pozitat
Personeli auditues	123		120		121	
Personeli profesional administrativ	27		27		27	
Total	150 ⁹	146	147	146	148	140

Proceset e rekrutimit

Ne vazhdimisht japim përparësi tërheqjes dhe mbajtjes së një kuadri profesional, e në veçanti, tregut konkurrues për profile punonjësish të auditimit. Rekrutimet tona bazohen në parimet dhe standardet më të mira të menaxhimit të Burimeve Njerëzore, duke respektuar parimet e Shërbimit Civil në Kosovë, dhe standardet e pranura ndërkombëtarisht të auditimit në sektorin publik (SNISA), si dhe në praktikat e mira evropiane.

Në vitin 2015, ne kemi pas gjithsejtë katër procese të rekrutimit për auditorë zëvendësues si dhe kemi vazhduar praktikën e angazhimit të përkthyesve të përkohshëm për të na ndihmuar në përkthimin e raporteve të auditimit.

Kemi pranuar mbi 600 aplikacione ku prej tyre janë testuar mbi 300 kandidatë. Prej tyre ne kemi angazhuar 4 punonjës të rinj në cilësinë e zëvendësuesve.

Po ashtu, gjatë procesit të ripërshtatjes së pozitave në auditim ne kemi organizuar edhe një proces të brendshëm për një pozitë udhëheqëse në auditim për të adresuar më mirë kërkesat e auditimit në nivelin lokal.

Trajnimi dhe zhvillimi

Ne vazhdojmë të investojmë në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe viti 2015 ka qenë përplot me aktivitete sa i përket trajnimit dhe zhvillimit.

Kanë vazhduar ciklet e trajnimeve të brendshme, gjatë muajve të trajnimit në Janar dhe Korrik. Kjo formë e Edukimit të Vazhduar Profesional (EVP) mban nivelin e kompetencës së personelit tonë në kryerjen e detyrave profesionale.

Kemi intensifikuar përpjekjet tona për të vendosur skemën e certifikimit për Auditorë të Performancës. Me ndihmën e partnerëve tanë nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë kemi mbajtur trajnime të veçanta për këtë fushë. Për të realizuar këtë projekt, ne kemi kërkuar përkrahjen edhe të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, përkatësisht nga Universiteti Amerikan në Kosovë.

Në kuadër të mbajtjes së kompetencës për nivelin drejtues, ne poashtu, kemi organizuar edhe një trajnim profesional në Menaxhim dhe Liderhip dhe pjesëmarrës ishin të gjithë udhëheqësit e departamenteve të ZAP.

⁹ Numri pozitave aktuale është më i lartë se sa taveni i lejuar për shkak të angazhimit të personelit shtesë (zëvendësues) për të zëvendësuar punonjësit në pushim të lehonise

Në total, ne kemi arritur t'i mbajmë 32 tema trajnimi që numërojnë 60 ditë të trajnimit e mbi 5000 orë trajnimi. Përveç trajnimeve, personeli ynë është aftësuar edhe përmes mentorimeve të ndryshme të ofruara nga partnerët tanë të binjakëzimit dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë.

Janë mbajtur edhe disa module të trajnimit nga Skema e re e Certifikimit për Auditorë të sektorit publik.

Në total, janë mbajtur dy module me gjithsejtë 18 pjesëmarrës.

Moduli 7 – Metodologjia e Auditimit – 14 pjesëmarrës

Moduli 8 – Menagjimi Financiar – 4 pjesëmarrës

Sa i përket dhënies së provimeve në këtë skemë, ne kemi pas 75 paraqitje të provimeve. Prej tyre 37 apo 49.3% janë kryer me sukses nga punonjësit tanë. Po ashtu, edhe një punonjës nga komuniteti serb ka përfunduar nivelin e fundit dhe ka arritur titullin profesional si Kontabilist I Çertifikuar.

Skema e Çertifikimit për Sektorin Publik ka gjithsejtë 3 nivele me 8 module profesionale sipas detajeve të dhëna në tabelë.

Tabela 8 : Skema e Çertifikimit të Sektorit Publik

Modulet	Nivelet	Numri auditoreve që kane kryer nivelet	%
M1 - Raportimi Financiar	Niveli i pare	12	11.8
M2 - Planifikimi dhe Buxhetimi			
M3 - Ligjet Kombetare (moduli ligjor)			
M4 - Procedurat dhe Teknikat e Manaxhimit të Financave Publike	Niveli i dytë	35	34.3
M5 - Qeverisja, Rreziku dhe Kontrolli			
M6 - Metodologjia e Auditimit I			
M7 - Metodologjia e Auditimit II	Niveli i tretë	48	47.1
M8 - Menaxhimi Financiar			
	Total	95 ¹⁰	100

Në tabelën e mësipërme, nuk janë paraqitur edhe 7 punonjës auditimi të cilët janë në proces të çertifikimit dhe nuk kanë kryer ndonjë nivel funksional e që në përqindje i bie 6.8%.

Poashtu, ZAP ka edhe 9 punonjës të auditimit të performancës për të cilët ka filluar të adresojë një skemë të veçantë të çertifikimit vetëm për specifika të Auditorëve të Performancës.

Ndërsa, sa i përket titujve të mbajtur në Skemën e Çertifikimit për sektorin privat, ZAP ka këtë pasqyrë:

¹⁰ Të dhënat janë azhurnuar sipas dhënjes së provimeve në Skemën e re të Çertifikimit për Auditor të Sektorit Publik.

Tabela 9 : Titujt funksional nga Skema e Çertifikimit të Sektorit Privat

Titulli funksional	2015	%
Auditor i Qertifikuar¹¹	27	25.5
Kontabilist i Qertifikuar¹²	31	29.2
Tcknik i Kontabilitetit¹³	28	26.4
Auditor ng trajnim/Student¹⁴	20	18.9
Total	106 ¹⁵	100

Janë edhe 4 punonjës të auditimit nga komuniteti serb, të cilët ndjekin programin e çertifikimit në Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Sërbisë. Prej tyre, një ka të fituar titullin Kontabilist i Çertifikuar, dy të tjerë kanë titullin Teknik i Kontabilitetit, ndërsa një prej tyre ende nuk ka të përfunduar asnjë nivel profesional. Të njëjtat janë të përfshirë në listën e mësipërme.

SISTEMI INFORMATIV PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është një sistem që ofron një pasqyrë të centralizuar të të dhënave të personelit tonë. Ky sistem përveç të dhënave të personelit ka të integruar edhe modulën e rekrutimit, të trajnimit, të përcjelljes së të dhënave rreth çertifikimit profesional të auditorëve si dhe modulën e regjistrimit të kohës në punë.

Moduli i regjistrimit të kohës në punë bën përcjelljen e punëve tona të përditshme në një mënyrë të avancuar që të përcjellim se si janë shfrytëzuar burimet tona. Poshtu ofron informata të rregullta dhe të besueshme menaxheriale që ndihmojnë planifikimin dhe mbikqyrjen e përdorimit të burimeve në mënyrë të efektshme. Informatat që nxirren janë të rendësishme për ne në shfrytëzimin efektiv dhe efikas të burimeve të disponueshme.

Ky sistem mbi të gjitha është një mjet i avancuar elektronik cili na ndihmon në kryerjen e punëve tona në mënyrë të efektshme me cilësi dhe në kohë.

SINDIKATA E PUNËTORËVE

Sindikata e punëtorëve të ZAP, apo Shoqata Sindikale e Punëtorëve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (SHSPZAP) është themeluar në vitin 2012 dhe që nga ajo kohë funksionon si një trup që synon të mbrojë interesin e anëtarëve të saj.

Aktualisht nuk kemi ndonjë rregullim të veçantë sa i përket komunikimit formal me sindikatën dhe kjo pritët të adresohet me Auditorin e ri të Përgjithshëm.

Ne vazhdojmë të mundësojmë kohë dhe ofrojmë kushte për veprimtari sindikale dhe këtë e realizojmë përmes ofrimit të hapësirave të zyrave, sallave për takime, pjesëmarrjes nëpër evente etj. Po ashtu, SHPZAP, vazhdon të përdor sistemin tonë të Intranetit, ku iu është alokuar një hapësirë e veçantë komunikuese me anëtarët e saj. Në fund të vitit 2015, SHPZAP kishte 86 anëtarë.

FOKUSI I ARDHSHËM

Me miratimin e Ligjit të ri për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, parashihet që të zhvillohen një sërë dokumentesh strategjike. Në mënyrë që të funksionojmë suksesshëm, ne kemi nevojë që fokusin tonë ta drejtojmë në zhvillimin e akteve të brendshme dhe ndërtimin e skemës së gradimit.

¹¹ Titujt funksional sipas Skemës së Çertifikimit për Auditor të Sektorit Privat

¹² Titujt funksional sipas Skemës së Çertifikimit për Auditor të Sektorit Privat

¹³ Titujt funksional sipas Skemës së Çertifikimit për Auditor të Sektorit Privat

¹⁴ Kategori e cila nuk ka kryer nivelin e pare në Skemën e Çertifikimit për Auditor të Sektorit Privat

¹⁵ Të dhënat janë azhurnuar sipas dhënjes së provimeve në Skemën e Çertifikimit për Auditor të Sektorit Privat.

4. BASHKËPUNIMI

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë është një mekanizëm kyç për të siguruar rezultate pozitive dhe promovuar ndryshime për të siguruar zhvillim efektiv institucional të ZAP-it. Kjo ka pasur ndikim përmes përmirësimit të cilësisë, shkëmbimit të përvojave dhe përfitimeve të ndërsjella për palët në fushën e zhvillimit profesional dhe menaxhimit të shëndoshë të fondeve publike.

Kuvendi, në veçanti Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) është partneri ynë kryesor lokal bashkëpunues. Qëllimi ynë i ndërsjellë është që të kemi ndikim në rritjen e vlerës që arrihet nga paraja publike dhe nga transparenca më e madhe në administratën shtetërore.

Komisioni duhet të rishikojë raportet tona të auditimit, të bëjë konkluzione dhe të kërkoj llogaridhënie nga Udhëheqësit e Institucioneve. Siç është shpjeguar në kapitullin 2 të këtij raporti, këto aktivitete janë ulur ndjeshëm gjatë vitit 2015 për shkak të ngërçit politik në mes të pozitës dhe opozitës. KMFP në përbërje të re ka iniciuar një qëndrim më të fortë në mbikëqyrjen parlamentare. Bashkëpunimi me Qeverinë, në veçanti me Ministrinë e Financave (MeF), ka qenë i vazhdueshëm, kur kemi të bëjmë me dhënien e këshillave në procesin e Menaxhimit të Financave Publike. Në vitin 2015 ne kemi marrë pjesë aktive në komitetin drejtues për kontrole të brendshme të financave publike (KBFP) duke promovuar zbatim më të mirë dhe efikas të legjislacionit në fushën e prokurimit dhe financave publike. Në të njëjtën kohë kemi ndihmuar Thesarin në MeF në përgatitje të Pasqyrave Vjetore Financiare si dhe në analizimin e pagesës së faturave të OB sipas vendimeve gjyqësore.

Ne kemi zhvilluar bashkëpunimin tonë me sektorin e Bujqësisë dhe Ministrisë së Mjedisit të Planifikimit Hapësinor për t'iu ndihmuar në evidentimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë. Tutje ne kemi ofruar rekomandime konkrete për kursime në procesin e furnizimit me libra shkollor dhe në menaxhimin e skemave pensionale dhe sociale.

Forcimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i organizatës është gjithmonë i nevojshëm. Bashkëpunimi ynë me mediat dhe shoqërinë civile luan një rol kyç në këtë. Gjatë vitit 2015 ne kemi trajtuar të gjitha kërkesat (11 raste) për çasje në dokumente publike sipas legjislacionit në fuqi për të promovuar tutje transparencën dhe raportimin.

4.1 PROJEKTET

Partnerët tanë ndërkombëtarë vazhduan të na ndihmojnë në vitin 2015 përmes projekteve të ndryshme.

Bashkëpunimi ynë nga projekti i binjakëzimit me partnerët tanë nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Britanisë së Madhe dhe Holandës përfundoi në qershor 2015. Ky projekt ka ndihmuar në zbatimin e Strategjisë sonë të Zhvillimit Korporativ. Fokusi ishte në mekanizmat për rritjen e cilësisë në auditimet e rregullsisë dhe zhvillimin e auditimeve jo-statutore në veçanti atë të TI. Në të njëjtën kohë për shkak të rëndësisë së vazhdimit të asistencës në zhvillimin e profesionalizimit, Zyra e Bashkimit Evropian ka vazhduar nga muaji nëntor të mbështesë tutje zyrën tonë me një projekt afatshkurtër të binjakëzimit e që do të vazhdoj deri në Korrik 2016. Objektive e këtij projekti është përmirësimi i mëtutjeshëm i cilësisë dhe qëndrueshmëria e auditimit.

Për të mbuluar hapësirën në mes të këtyre dy projekteve të përmendura më lartë donatorë tjerë kanë shprehur gatishmërinë për të ndihmuar këtë zyrë në këtë fazë kritike. Këta donatorë ishin:

Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë, Ambasada e Norvegjisë në Kosovë, Zyra Gjermane përmes GIZ si dhe projekti i financuar nga zviceranët DEMOS. Këta partnerë ndihmuan zyrën në disa objektiva:

- Adresimin e përgatitjes së platformës për Auditorin e ri të Përgjithshëm;
- Përmbylljen e sezonit të Auditimit 2014-2015; si dhe
- Fillimin e sezonës së auditimit 2015-2016.

Për sa i përket bashkëpunimit tonë bilateral me ZKA-në Suedeze fokusuar drejt zhvillimit të auditimit të performancës është në vazhdim e sipër dhe drejt thellimit. Ky projekt përfundon në mes të vitit 2016 dhe tanimë janë bërë diskutimet për vazhdim të mëtutjeshëm deri në mes të vitit 2017.

Projekti i financuar nga Banka Botërore i fokusuar në zhvillimin e auditimit të vlerës për para në sistemet e prokurimit përfundoi në muajin Maj 2015.

4.2 RRJETI

Aktivitetet në Rrjet

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm gjatë vitit 2015 ka vazhduar angazhimin e vet në kuadër të punës dhe aktivitetëve në Rrjetin e Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA) të shteteve kandidate dhe kandidate potenciale për në BE si dhe në Grupin Punues për Aktivitete të përbashkëta në Auditim.

Në kuadër të kësaj ka marrë pjesë në takimin e radhës të këtij Rrjeti të mbajtur në Lubjanë të Sllovenisë.

Në të njëjtën kohë po në Lubjanë, është mbajtur edhe takimi i zyrtarëve ndërlidhës të Komitetit të Kontaktit të ISA-ve, vende anëtare të BE dhe Kosova është ftuar të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit.

ZAP ka dhënë kontribut dhe ka qenë aktiv në Rrjet. Sipas planit të punës së Rrjetit për vitin 2015, të përcaktuar në takimin e Presidentëve të mbajtur në Budva, ZAP ka marrë pjesë në punëtori të ndryshme, grupe punuese, ka shkëmbyer të dhëna dhe ka dhënë kontribut në hartimin e dokumenteve të ndryshme për të vlerësuar nevojat dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të Rrjetit.

Ka përfunduar me sukses auditimin paralel të performancës "Sistemi për efikasitet të energjisë ka nevojë për tu fuqizuar" projekt i përbashkët me vendet e rajonit, Shqipërinë dhe Bosnjë dhe Hercegovinën si pjesëmarrëse aktive, ndërsa vendet tjera ishin vëzhgues në këtë projekt. Ky proces auditimi deri në finalizimin e tij ka zhvilluar 6 punëtori, fazat e diskutimeve në nivel rajonal, janë shkëmbyer përvoja dhe janë bërë analiza e krahasime sa i përket efikasitetit të energjisë në vendet përkatëse. Raporti është publikuar dhe pritet të diskutohet në Kuvend.

Ka marrë pjesë në punëtorinë rajonale me temë mbi "Materialitetin dhe auditimin bazuar në kampione", organizuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit të Shqipërisë me përkrahjen e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe me pjesëmarrës tjerë nga Maqedonia, Bosnje dhe Hercegovina, Mali i Zi, Turqia dhe Serbia.

Për të zhvilluar më tutje bashkëpunimin e qëndrueshëm dhe për të shkëmbyer pikëpamjet lidhur me përvojat, sfidat dhe qasjen në të ardhmen, ZAP ka ftuar në Konferencën e vet të VII-të Vjetore partnerët nga ISA-it e vendeve të rajonit.

Përfaqësues të lartë nga ISA-të e Shqipërisë, Mali të Zi dhe Maqedonisë, morën pjesë në punimet e Konferencës si dhe në një takim të ndarë me grupin e menaxhmentit të ZAP.

Gjithashtu gjatë vitit 2015 kanë filluar përgatitjet për vazhdimin e fazës së dytë të auditimeve paralele të shteteve të përfaqësuara në Rrjet.



5. FOKUSI I ARDHSHËM

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka arritur një nivel të mirë të konsolidimit dhe ka përmbushur me sukses objektivat e saj.

Në vazhdim, ne kemi përpara një varg të sfidave që kanë të bëjnë me aspektet strategjike të menaxhimit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të organizatës.

Nxjerrja e Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditorit të Përgjithshëm kërkon vister veprimesh për adaptimin e strukturave të reja organizative dhe ndryshimin e përshtatjen e legjislacionit dytësor. Më tej, modifikimi i përmbatjes së Strategjisë të zhvillimit të përbashkët për periudhën 2014-2020 duhet konsideruar sikurse edhe ndryshimet dhe plotësimet e Manualit të Auditimit të Rregullsisë dhe Manualit të Performancës. Ne kemi nevojë të fokusohemi në zhvillimin e mëtejme të Skemës së Çertifikimit të Auditorëve të Sektorit Publik dhe të marrim vendimet mbi mësimet e marra deri më tani lidhur me këtë skemë.

Në periudhën e ardhshme ne dëshirojmë të mbajmë në vëmendje objektivat parësore që kanë të bëjnë me: (i) sigurimin e qëndrueshmërisë institucionale, pas ndërrimit të Kreut të Zyrës dhe Legjislacionit, (ii) promovimi dhe kontributi në qeverisjen e mirë si dhe (iii) zhvillimi dhe përmirësimi i cilësisë së auditimit dhe organizatës në tërësi.

Për të gjitha këto, ne synojmë që të kryejmë veprimet në vijim:

- Përgatitja e Planit vjetor të auditimit për sezonin 2016/2017;
- Finalizimi dhe zbatimi i Udhëzuesve të brendshëm që derivojnë nga legjislacioni i ri;
- Vazhdimi dhe thellimi i partneritetit afatgjatë me partnerët tanë;
- Zhvillimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit rajonal me organizatat simotra dhe pjesëmarrja aktive në rejtin ndërkombëtar në këmbimin e përvojave;
- Ngritja dhe forcimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të brendshme administrative dhe menaxhimi i suksesshëm i ndryshimeve.
- Konsolidimit të cilësisë së Auditimit të Rregullsisë dhe forcimit të Auditimit menaxherial dhe të Performancës.
- Vendosja e fokusit më të madh në fushën e performancës;
- Ndërmarrja e auditimeve të fondeve të donatorëve;
- Ndërmarrja e auditimeve të ndërmarrjeve publike
- Vazhdimi i mbështetjes për funksionin e mbikëqyrjes parlamentare me qëllim të fuqizimit të mëtejme të llogaridhënies publike;
- Bashkëpunimi dhe komunikimi i shtuar me shoqërinë civile, mediat dhe projektet.
- Forcimi i funksionit të cilësisë përmes kontroleve të shtuara me rastin e hartimit të planeve dhe programeve të auditimit, dhe prodhimit të raporteve individuale të auditimit, Raportit Vjetor të Auditimit dhe Raportit Vjetor të Performancës;
- Të nxisim çertifikimin e stafit dhe të zbatojmë plotësisht skema të çertifikimit;
- Rritja e efikasitetit përmes futjes në përdorim gjatë vitit 2016 të një softueri të auditimit dhe aplikacioneve tjera të TI-së; dhe
- Të qenit konsistent dhe në pajtim me ndryshimet dhe kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik

6. LLOGARIDHËNIA E ZAP

Sigurimi i integritetit

Përmes kësaj, garantoj se informacioni në Raportin Vjetor të Performancës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2015, përfshirë edhe pasqyrat vjetore financiare janë të sakta, të besueshme, dhe objektive.

Artan Venhari, Ushtrues Detyre i Auditorit të Përgjithshëm gjatë vitit 2015 dhe Zëvendës Auditor I Përgjithshëm

Deklarata e Transparencës

Përmes kësaj, garantojmë se puna jonë gjatë vitit 2015 është kryer në pajtim me Statutin e Shërbimit Publik dhe Kodin e mirësjelljes së ZAP-it

Ilire Daija-Buza, Ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm

Ibrahim Gjylderan, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: PARATHËNIE E SHKURTËR PËR ZYRËN E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

ROLI

Auditori i Përgjithshëm është institucion kushtetues i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. ZAP ndihmon Auditorin e Përgjithshëm, mandati dhe detyrat e të cilit janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë. Që nga shtatori i vitit 2014 deri më 31 Mars 2016 zyra është udhëhequr nga ushtruesi i detyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Më 1 Prill ka filluar punë Auditori i Përgjithshëm i emëruar nga Kuvendi pas propozimit të Presidentes së Kosovës.

Në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij, Auditori i Përgjithshëm gëzon liri të plotë të ndërmarrë veprimet e duhura në funksion të mandatit të tij dhe përgjigjet vetëm para Kuvendit.

Ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë tonë nga organizatat të cilat i auditojmë është vendimtare.

Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me anë të zbatimit të mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm, dhe ligjor; pajtueshmërisë me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht, dhe një kod të brendshëm për mirësjelljen profesionale.

AKTIVITETI YNË

Ne kryejmë Auditimet e Rregullsisë të Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore në bazë vjetore, ku përfshihen Kuvendi, Zyra e Presidentit, çdo ministri dhe agjenci ekzekutive, komunat, organet e pavarura dhe entitete të tjera.

Ne gjithashtu kryejmë Auditime jo-statutore si ato të Performancës, fondeve të donatorëve, auditime të sistemeve të TI. Kjo është në fushëveprimin tonë, por nuk është një kërkesë vjetore e parashikuar me ligj. Këto auditime kryhen në mënyrë që të vlerësojmë nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar si duhet, ekonomikisht, dhe në mënyrë efikase, dhe nëse janë vendosur masa për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

Ne raportojmë për auditimet tona tek entitetet e audituara dhe Kuvendi (KMFP) dhe këto raporte publikohen. Raportet tona përmbajnë rekomandime me qëllimin për të nxitur ndryshim dhe praktika më të mira. Me këtë duam t'i ofrojmë Kuvendit, Qeverisë, dhe Taksapaguesve një shërbim auditimi profesional të bazuar në fakte dhe të integruar.

Me qëllim që të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, ne do të sigurojmë tatimpaguesit dhe donatorët ndërkombëtar se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase. Ne e bëjmë këtë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrën e duhur dhe me maturi.

PROCESI I LLOGARIDHËNIES

Pasqyrat tona Vjetore Financiare (PVF) përgatiten sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ato janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik mbi Bazat e Parasë së Gatshme dhe modifikimet e aplikueshme sipas vendimit të Qeverisë. Për të na mundësuar të dëshmojmë përgjegjshmërinë dhe objektivitetin tonë, Kuvendi çdo vit duhet të emërojë një auditor të jashtëm për të bërë auditimin e PVF-ve tona.

Opinionin e auditimit mbi PVF-të e vitit 2015 është përfshirë në Raportin Vjetor të Performancës, së bashku me PVF-të. Në letrën e auditorëve të jashtëm drejtuar menaxhmentit janë përfshirë shkurtimisht rekomandimet si dhe komentet tona ndaj tyre. Në këtë mënyrë ne ua mundësojmë lexuesve të kenë një pamje,

pas auditimit, rreth mënyrës se si i kemi përdorur burimet që na janë dhënë dhe rezultatet nga kjo. Raportet janë të publikuara në faqen tonë të internetit¹⁶

Përpos auditimeve të jashtme, edhe auditimet e brendshme të kryera nga njësia për auditim të brendshëm sigurojnë Auditorin e Përgjithshëm në detyrë që Zyra vepron në pajtueshmëri me ligjet dhe politikat e veta.

KUSH DO T'I VLERËSOJË METODOLOGJITË TONA TË AUDITIMIT?

Ne kemi bërë shumë për të siguruar që të ndjekim praktikën dhe metodologjinë e mira të auditimit. Ne jemi duke zbatuar një kornizë të menaxhimit të cilësisë. Metodologjinë e mira dhe korniza e cilësisë sigurojnë që auditimet tona kryhen në pajtim me standardet¹⁷ e themeluara të praktikës profesionale.

Ne ndjekim sistemin e rregullt ndërkombëtar të kontrolleve mbi punën tonë të auditimit; auditimet tona ekzistojnë brenda një kornize rigoroze të standardeve të auditimit, të cilën stafi mëson se si ta përdorë gjatë programit tonë të trajnimit. Pastaj, gjatë një procesi qartësimi, diskutohet me entitetet e audituara për të gjeturat e auditimit. Në sistemin tonë është ndërtuar rishikimi nga ana e menaxhmentit dhe monitorimi i mëtejshëm bëhet nga një funksion i veçantë në kuadër të Zyrës. Pas kësaj, raportet tona publikohen dhe janë të hapura për ekzaminim. Pastaj fillojnë shqyrtimet dhe diskutimet në Kuvend së bashku me Ekzekutivin rreth rekomandimeve të auditimit.

Përveç kësaj, cilësia e auditimeve tonë vlerësohet nga partnerët dhe/ose organet e jashtme që vlerësojnë dhe monitorojnë marrëveshjet mes Kosovës dhe BE-së.


KUSH DO TË RISHIKOJË FINANCIMIN TONË?

Si Auditor i Përgjithshëm në detyrë, unë – përveç këtij Raporti Vjetor të Performancës që fokusohet në mënyrën se si është shpenzuar buxheti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm – do të përgatis dhe dorëzoj çdo vit në Kuvend kërkesat buxhetore. KMFP dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të më drejtohen mua për të shpjeguar kërkesën buxhetore për Zyrën dhe për të diskutuar raportin tonë mbi planet dhe prioritetet, objektivat e performancës, raportin tonë vjetor të performancës, dhe praktikën tonë të menaxhimit.

Qeveria inkorporon kërkesën time buxhetore në Buxhetin e propozuar të Kosovës dhe mund të jap komente për të në një dokument të veçantë. Buxheti i zyrës miratohet nga Kuvendi.

¹⁶ www.oag-rks.org

¹⁷ ISSAI, International Standards of Supreme Audit Institutions përcaktojnë parakushtet themelore për funksionimin e duhur dhe sjelljen profesionale të institucioneve të tilla: WWW.ISSAI.ORG



SHTOJCA 2: NUMRI DHE LLOJI I AUDITIMEVE

Në fund të sezonit të auditimit 2014/2015 kemi publikuar 117 raporte të auditimit, përfshirë:

Raportin Vjetor i Auditimit për Raportin Vjetor financiar të Buxhetit të Kosovës të vitit 2014;

89 raporte të auditimit të rregullsisë:

- Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Presidentit dhe Zyrën e Kryeministrit,
- 19 Ministri,
- 38 Komuna,
- 27 Institucione të Pavarura, si dhe
- Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës Dy Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Financave¹⁸);

16 raporte të auditimit të performancës:

1. Grantet e bujqësisë në Komunën e Fushë Kosovës,
2. Monitorimi i zotimeve të blerësve të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara me metodën e spin off special,
3. Qasja për personat me aftësi të kufizuara fizike,
4. Grantet e bujqësisë në komunën e Gjakovës,
5. Shpenzimet e derivateve në Komunën e Malishevës,
6. Sistemi për efikasitet të energjisë ka nevojë për tu fuqizuar,
7. Performanca financiare dhe shërbimi i ofruar në komuna në vitin 2014:
8. Të dhëna krahasuese dhe indikatorë të performancës - Dokument diskutimi,
9. Grantet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
10. Grantet Komunale në sektorin e bujqësisë - Komuna e Prizrenit,
11. Zbatimi dhe arkitektura e strategjisë së qeverisjes elektronike 2009-2015,
12. Përgjegjësia e monitorimit në përdorimin e pajisjeve mjekësore,
13. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare,
14. Dizajni dhe funksionimi i Sistemit të Menaxhimit të Radiotelevizionit të Kosovës,
15. Aktivitetet e policisë së trafikut dhe siguria në trafikun rrugor, si dhe
16. Sistemet e prokurimit në sektorin shëndetësor; dhe

11 raporte të auditimit të fondeve të donatoreve:

1. Rivitalizimi i Sheshit të Lidhjes së Prizrenit,
2. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të zyrës së TAMAD-it për periudhën janar – shtator 2015,
3. Raport i auditimit për projektin 'Rregullimi i korridoreve të gjelbëruara në komunën e Ferizajt,
4. Projekti 'Rregullimi i hapësirave publike në Gorancë dhe Paldenicë' – Hani i Elezit,
5. Projekti për rregullimin e shkollës së mesme dhe parqeve në Mamushë,
6. Fondi i Bashkuar për Sektorin e Arsimit,

¹⁸ Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë agjenci ekzekutive të Ministrisë së financave. PVF-të e tyre integrohen brenda PVF-të të MF-së. Mirëpo për shkak se mbi 80% e të hyrave të BK-së mbliidhen prej tyre ato l kemi audituar ndaras nga PVF-të e MF-së.

7. Projekti "Zgjerimi i urës" në Malishevë,
8. Projekti "Renovimi i objektit shkollor, rregullimi i oborrit të shkollës dhe i terrenit sportiv" – në fshatin Radevë të komunës së Graçanicës,
9. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të zyrës së TAMAD-it për vitin 2014,
10. Projekti – Rregullimi i oborreve të Shkollës së Mesme "Xhelal Hadja –Toni" në Rahovec dhe Shkollës Filllore "Hamëz Thaçi" në Xërxë, si dhe
11. Projekti - Shtrimi Me kubëza betoni nga shkolla fillore "Ilaz Thaçi" deri te Dheu i Bardhë - në Han të Elezit.

Sezoni i auditimit 2015/16 ka filluar në shtator të vitit 2015 dhe planifikojmë të përfundojmë 109 raporte të auditimit si:

Raporti Vjetor i Auditimit për Raportin Vjetor financiar të Buxhetit të Kosovës të vitit 2015

90 auditime të rregullsisë në proces:

- (Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Presidentit, Zyrën e Kryeministrit, 19 Ministri, 38 Komuna, 28 Institucione të Pavarura, si dhe dy Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Financave);

17 auditime të performancës në proces:

1. Procesi i blerjeve të librave shkollorë,
 2. Trajtimi i pacientëve jashtë ISH,
 3. Ambienti,
 4. Cilësia e përmbajtjes së librave shkollorë,
 5. Sistemi Informativ Shëndetësor,
 6. Përcjellja e auditimit-Zbatimi i kontratës me ANP,
 7. Ndërtimtaria,
 8. TI-Prokurimi elektronik,
 9. Siguria në punë,
 10. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,
 11. Investimet e huaja,
 12. Përcjella e auditimit,
 13. Banesat,
 14. Furnizimi me ushqim,
 15. Mirëmbajtja e rrugës, dhe
 16. Auditimet paralele¹⁹ (Investimet e huaja direkte dhe Mangësitë në sistemin e prokurimit);si dhe
- Një auditim i fondeve të donatoreve në proces: është vetëm auditimi i Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit. Megjithatë deri në fund të sezonit të auditimit pritet të ketë edhe kontrata të reja.

¹⁹ Auditimet paralele do të bëhen në bashkëpunim më vendet e rajonit, nën mbikëqyrjen e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Suedi.

SHTOJCA 3: PASQYRAT VJETORE FINANCIARE PËR VITIN 2015 DHE ADRESIMI I REKOMANDIMEVE PËR VITIN 2014

Pasqyra financiare 1.

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2015

Shënime shpjeguese	2015		2014		2013	
	Llogaria e Vetme e Thesarit	Pagesat nga palet e treta	Llogaria e Vetme e Thesarit	Pagesat nga palet e treta	Llogaria e Vetme e Thesarit	Pagesat nga palet e treta
	BK	BK	BK	BK	BK	BK
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
BURIMET E FONDEVE						
Granti Qeuesitar	1	2,140	2,112		1,985	
Grantet e përcaktuara të donatorëve	2	63	57		21	7
Totali i Pranimeve		2,203	-	2,169	-	2,006
SHFRYTËZIMI I FONDEVE						
Operacionet						
Paga dhe Mëditje	3	1,613	1,480		1,268	
Malra dhe Shërbime	4	564	644		614	7
Shërbime Komunalet	5	26	27		29	
		2,203	-	2,151	-	1,911
Transfere dhe Subvencione					75	
Shpenzime Kapitale	6		18		20	
			18		95	
Totali i Pagesave		2,203	-	2,169	-	2,006

Pasqyra financiare 2.

Pasqyra e realizimit të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2015

Shënime shpjeguese	2015				2014		2013	
	Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti Final (SIMFK)	Realizimi	Variance D=C-B	Realizimi	Realizimi		
	A	B	C	D=C-B	E	F		
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit								
Donacione	7	-	105	90	(15)	18	21	
Te hyrat tjera	8		11	11	-	4		
Pranimet totale të mbledhura për FKK-në		-	116	101	(15)	22	21	
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e thesarit								
Paga dhe Mëditje	9	1,574	1,613	1,613	-	1,480	1,268	
Malra dhe shërbime	10	605	594	564	(30)	644	614	
Shërbime komunale	11	34	27	26	(1)	27	29	
Transfere dhe Subvencione				-	-	0	75	
Shpenzime kapitale				-	-	18	20	
Totali i pagesave i bërë nga BRK përmes LIVTh		2,213	2,234	2,203	(31)	2,169	2,006	

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

BURIMI I FONDEVE

Shënimi shpjegues 1. Ndarjet e fondit të përgjithshëm

Klasifikimi ekonomik	Shënim	2015	2014	2013
		BK	BK	BK
		€ '000	€ '000	€ '000
Paga dhe mëditje		1,613	1,480	1,268
Malra dhe shërbime		501	587	593
Shërbime komunale		26	27	29
Subvencione dhe transfere			-	75
Shpenzime kapitale			18	20
Totali		2,140	2,112	1,985

Shënimi shpjegues 2. Grantet e përcaktuara të donatorëve

Klasifikimi ekonomik	Shënim	2015	2014	2013
		BK	BK	BK
		€ '000	€ '000	€ '000
Malra dhe Shërbime		63	57	21
Totali	2.1	63	57	21

2.1 Në këtë shpenzim përfshihen:

a) Paguesa prej 19,975€, donacionin nga: Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë (10,000€) dhe Ambasada Norvegjeze në Kosovë (9,975€) për të financuar këshilltarin e u.d. Auditorit të Përgjithshëm në finalizimin e sezonit të auditimit 2014 - 2015 si dhe për planifikimin e sezonit të ardhshëm 2015 - 2016;

b) Paguesa prej 5,815€, donacionin nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë për të financuar këshilltarin për mbështetje dhe mentorim të ekipeve audituese në divizionit e auditimit të rregullsisë; dhe

c) Paguesa prej 37,000€, donacionin nga Banka Botërore për financimin e projektit "Zhvillimi i aftësive profesionale në auditimin e vlerës për para në sistemet e prokurimit".

SHFRYTËZIMI I FONDEVE

Shënimi shpjegues 3. Pagat dhe rrogat

Përshkrimi	Shënim	2015	2014	2013
		BK	BK	BK
		€ '000	€ '000	€ '000

Pagesat nga BK

Pagat neto përmes listës së pagave	1,349	1,240	1,066
Tatimi mbi të hyrat personale	106	96	77
Kontributi pensional nga punëdhënësi	77	70	60
Kontributi pensional nga i punësuar	77	70	60
Pagësa për Sindikatë	4	4	5
Totali	1,613	1,480	1,268

Shënimi shpjegues 4. Mallrat dhe shërbimet

	2015		2014		2013	
		BK		BK		BK
Përshkrimi						
Pagesat nga BK	Shënimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	4.1	46	35	33		
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	4.2	37	35	31		
Internet		1	1	3		
Shpenzimet tjera telefonike /z.mobile		21	22	23		
Shpenzimet postare		1	1	1		
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	4.3	42	98	108		
Shërb e ndr.intelektuale këshilldhënëse	4.4	75	66	57		
Shërb kontraktuale tjera	4.5	33	22	23		
Shërbime teknike		1	1	1		
Shpenzimet për anëtarësim		-	2	1		
Mobiljet dhe pajisjet(më pak se 1000)	4.6	2	9	2		
Telefona (më pak se 1000€)		0	0	0		
Kompjuterë (më pak se 1000€)	4.7	6	34	-		
Hardwer për TI<1000	4.8	6	-	0		
Pajisje tjera <1000€		4	2	2		
Furnizime për zyrë	4.9	16	5	25		
Furnizime ushqim dhe pije		18	20	12		
Furnizime pastrimi		0	0	2		
Furnizime veshmbathje		1	-	1		
Akomodimi	4.10.	8	23	5		
Vaj për ngrohje		11	8	12		
Derivate për gjenerator		0	1	0		
Karburant për vetura		6	8	11		
Regjistrimi i automjeteve		0	1	1		
Sigurimi i automjeteve		2	2	5		
Taksa komunale		0	0	0		
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera		11	14	13		
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve		6	9	13		
Mirëmbajtja e ndërtesave		12	14	13		
Mirëmbajtja e tekn.informative		12	10	14		
Mirëmb.e mobileve dhe pajisjeve		1	1	1		
Qinaja për ndërtesa	4.11	154	168	168		
Qinaja-pajisje	4.12	20	24	19		
Qinaja perlorime tjera te hapshirave		0	1	1		
Reklammat dhe konkurset		1	1	1		
Shërbime shtypje -jo marketing	4.13	9	5	9		
Informimi publik		-	-	0		
Drekat zyrtare		1	1	3		
Totalit:		564	644	614		

4.1 Këto shpenzime reflektojnë intensitetin më të lartë të ekipeve të auditimit në terren - akomodimi në hotele në Komunat te cilat janë 50km larg Prishtinës. Diferenca mes shpenzimeve të vitit 2015 dhe 2014 ka të bëjë me rritjen e numrit të auditimeve të performancës në Komunat të cilat janë 50km larg Prishtinës

4.2 Bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar është pjesë e portfolios tonë. Mjetet e shpenzuara ndërlihen me pjesëmarrjen e stafit në punëtori dhe konferenca jashtë Kosovës. Përveç tjerave janë të përfshira edhe shpenzimet e udhëtimit për auditimet e ambasadave (Punëtori në Maqedoni, Slloveni, auditimi në Zvicër, Holandë, auditimi në Luksemburg, Serbi, Angli dhe Brukseli). Në ngritjen e shpenzimeve gjatë vitit 215 krahasuar me vitin paraprak, ndikim te theksuar ka pasur pjesëmarrja e stafit tonë në projektin e auditimeve paralele me Zyret Kombëtare të Auditimit të shteteve fqinje.

4.3 Kjo shumë prezanton shpenzimet për: Trajnimet e mbajtura nga SHKÇAK (19,654 €) dhe AUK (4,356 €) për stafin e auditimit; Trajnimin e mbajtur nga International Centre for Parliamentary Studies -ICPS nga Anglia (10,000 €) për menaxhmentin e lartë dhe të mesëm në programin "Professional Certificate in Management and Leadership", mbajtur në Prishtinë nga data 07-10.12.2015. Shpenzimet më të ulta krahasuar me vitin 2014 janë për arsye që shumica e auditoreve të rregullsisë i kanë përfunduar ligjeratat dhe provimet e tyre vitin e kaluar. Skema e certifikimit për auditorët e performancës është implementuar pjesërisht.

4.4 Përveç pagesave për kompanitë private të auditimit të kontraktuara për auditimin e PVF të një numri të komunave të Kosovës, këto shpenzime përfshijnë edhe pagesën në vlerë prej 37,000 € nga donacioni i Bankës Botërore për ekspertët e angazhuar në projektin "Zhvillimi i aftësive profesionale në auditimin e sistemeve të prokurimit në sektorin publik", pagesën në vlerë prej 19,974 € nga donacionet e Ambasadës së Mbreterisë së Bashkuar në Kosovë dhe Ambasadës së Norvegjisë në Kosovë për këshilltarin e u.d. Auditorit të Përgjithshëm për finalizimin e sezonës së auditimit 2014/2015 si dhe për planifikimin e sezonës së auditimit 2015/16. Përveç këtyre, këtu përfshihet edhe pagesa prej 5,815 € nga donacioni i Ambasadës së Mbreterisë së Bashkuar në Kosovë për këshilltarin e Divizionit të auditimit të rregullsisë.

4.5 Shpenzimet e rritura gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin 2014 janë si shkak se, që nga shtatori i vitit të kaluar, pozita e u.d. Drejtor i Përgjithshëm është duke u paguar nga kategoria Mallra dhe Shërbime deri në miratimin e ligjit të ri për Zyrën Kombëtare të Auditimit. Përveç kësaj, është angazhuar një ekspert për auditimin e sistemeve të TI-së, nga shtatori i vitit të kaluar, me synim zhvillimin e kësaj fushe auditimi.

4.6. Diferenca e shpenzimeve, krahasuar me vitin e kaluar, është si rezultat i nevojave/kërkesave më të vogla.

4.7 Furnizimit i stafit me pajisje të TI-së (Laptopë) nga vitet e kaluara, ka rezultuar me nevoja më të vogla për blerje në 2015.

4.8 Kjo shumë paraqet shpenzimin për blerjen e 40 monitorëve me performanca më të avancuara.

4.9. Kjo shumë paraqet shpenzimet për furnizim me material zyrtar, tonerë dhe gazeta ditore. Në vitin 2014 nuk është blerë material zyrtar dhe kemi mbuluar nevojat me stoqet e vitit 2013. Në fillim të vitit 2015 është përfunduar procesi i blerjes së materialit zyrtar.

4.10. Kjo shumë paraqet shpenzimet për akomodimin e ekspertëve të angazhuar nga Banka Botërore gjatë misionëve të tyre në ZAP. Këto fonde janë donacion i Bankës Botërore. Mbajtja e konferencës së shtatë vjetore e vitit 2015 në Prishtinë ka ndikuar në ulje të përgjithshme të shpenzimeve në këtë kod.

4.11. Shpenzimet më të ulëta në vitin 2015 krahasuar me dy vitet paraprake janë rezultat i një procesi të ri për qiranë. Nga shtatori, qiraja mujore për të njëjtën ndërtesë është ri-negociuar dhe marrëveshja e re ka rezultuar me një ofertë më të lirë.

4.12 Shpenzimet e këtij viti nuk përfshijnë qiranë për softuerin e regjistrit të kohës (TRS), për faktin se kemi blerë një softuer të posaçëm përmes investimeve kapitale në 2014.

4.13. Shpenzimet e këtij viti janë më të larta krahasuar me vitin 2014 janë për arsye të çmimeve më të larta të ofruara nga operatori ekonomik për shtypje dhe lidhje të RVP & RVA, si shkak i kërkesave më të avancuara të specifikave teknike me qëllim të sigurimit të cilësisë më të mire të kopjeve të shtypura.

Shënimi shpjegues 5: Shërbimet komunale

Përshkrimi	Shënim	2015	2014	2013
		BK	BK	BK
		€ '000	€ '000	€ '000
Rryma	5.1	21	19	18
Uji		1	1	2
Mbeturinat		1	1	1
PTK-fikse	5.2	3	6	8
Totali		26	27	29

Shënim:

5.1 Rritja e çmimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2015 ka rezultuar në rritje e shpenzimeve, krahasuar me vitin 2014.

5.2 Implementimi i pakos biznesore të telefonisë mobile ka ulur koston për shërbime të telefonisë fikse.

Shënimi shpjegues 6: Shpenzime kapitale

Përshkrimi	Shënim	2015	2014	2013
		BK	BK	BK
		€ '000	€ '000	€ '000
Blerja e serverëve				
Softuer për intranet			3	6
Pajisje tjera (Skaner dhe fajla metalik)				10
Softuer për dizajnim të raporteve				4
Softuer për menaxhimin e butimeve njerëzore			8	
Softuer për regjistrim të kohës			7	
Totali		0	18	20

Shënimi shpjegues 7: Donacionet

Emri i Donatorit	Shënim	Emri i projektit	2015
			€ '000
Banka Botërore		Zhvillimi i aftësiwe profesionale në auditimin e sistemeve të prokurimit	64
Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar		Këshilltar i u.d. Auditorit të Përgjithshëm për finalizimin e sezonit të	10
Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar		Këshilltar për divizionin e auditimit të rregullisë	6
Ambasada Norvegjeze		Këshilltar i u.d. Auditorit të Përgjithshëm për finalizimin e sezonit të auditimit 2014 - 2015 si dhe për planifikimin e sezonës së ardhshëm 2015 - 2016	10
Totali:			90

Shuma e planifikuar e donacioneve gjatë vitit 2015 ka qenë në vlerën 105,322, dhe atë:

- 79,533 donacioni i Bankës Botërore (prej te cilave 39,029 rimbursim nga shpenzimet e vitit 2014);
- 15,815 donacione nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, si dhe
- 9,974 donacion nga Ambasada Norvegjeze.

Nga shuma e planifikuar, janë realizuar 89,509. Banka Botërore mbetet që gjatë vitit 2016 të rimbursoj 12,310 (të shpenzuara gjatë 2015) ndërsa 3,504 mbesin të pashfrytezuara.

Shënimi shpjegues 8: Të hyra të tjera

Shumat e mëposhtme paraqesin të hyrat e gjeneruara nga auditimet tona për fondet e donatorëve.

- 1,490 - nga auditimi i Pasqyrave Financiare të TAMAD-it, për periudhat : Janar - Dhjetor 2014 si dhe Janar-Shtator 2015; (marrëveshja me TAMAD);
- 7,055 - nga auditimi i projekteve të UN Habitatit; (marrëveshja me UN Habitat Nr. 09/2013);
- 2,220 - nga auditimi i Pasqyrave financiare të Fondit të Grumbulluar të sektorit të Arsimit (MEST/ESPF) për periudhën Janar - Dhjetor 2014.

Shumat e prezantura më lartë janë të hyra tona të regjistruara në Llogarinë kryesore të Buxhetit të Kosovës dhe nuk janë përdorur nga ne.

Shënimi shpjegues 9: Paga dhe Mëditje

Me ligjin Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, shuma e aprovuar në kategorinë Paga dhe Mëditje ishte 1,573,740 , derisa me Ligjin nr. 05/L- 046 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001, na është ndarë edhe një buxhet shtesë prej 1,775 për mbulimin e nevojave. Diferenca mes buxhetit të aprovuar (1,575,515) dhe të shpenzuar (1,613,332) është si rezultat i implementimit të vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.06/29, me të cilën nga maji 2015 ka filluar pagesa shtesë mbi përvojën e punës për të gjithë shërbyesit civil.

Shënimi shpjegues 10: Mallra dhe Shërbime

Me ligjin Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, shuma e aprovuar për Mallra dhe

Shërbime ishte 604,775. Ndryshimet mes buxhetit të aprovuar dhe atij final janë:

- Me Ligjin nr. 05/L-046 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001, ndarja buxhetore për Mallra dhe Shërbime u shkurtua për 53,486
- Me Vendimin Nr. 09/65 të Qeverisë së Kosovës, i datës 23.12.2015, ndarja buxhetore për Mallra dhe Shërbime u shkurtua për 23,661 .

Gjatë kësaj periudhe, ne kemi marrë donacionet në vlerë 66,294 , të cilat janë alokuar për Mallra dhe Shërbime.

Buxheti final ishte 593,922

Shënimi shpjegues 11: Shërbime komunale

Me ligjin Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, shuma e aprovuar për Shërbime komunale ishte 34,000

Me Vendimin Nr. 09/65 të Qeverisë së Kosovës, i datës 23.12.2015, ndarja buxhetore u shkurtua me 7,333

Pasqyra e obligimeve të organizatës buxhetore

2015							Shuma		
Data e faturës	Numri i faturës	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	Arsyeja e mospagesës				
4.12.2015	557-2015	30 ditë	Zyra e Kryeministrit	Gazeta zyrtare	Skadimi i afatit për zotim	8 €			
22.12.2015	101203/15	30 ditë	Comtel	Mirëmbajtje e intranetit	Skadimi i afatit për zotim	458 €			
08.01.2016	3899/15	30 ditë	Petroll Company	Naftë për veturë		254 €			
1.01.2016	123115387	30 ditë	Dardafon	Telefonia mobile		1,373 €			
08.01.2016	D11702	30 ditë	Delta Security	Sigurimi i objektit		959 €			
04.01.2016	009/2016	30 ditë	KIOSK	Gazeta ditore	Këto fatura janë pranuar në muajin janar 2016 dhe pasqyrojnë obligimet për shërbimet e dhëna nga furnitorët relevantë në dhjetor 2015.	57 €			
13.01.2016	46/16-A	30 ditë	Silca	Ujë për pijë		187 €			
15.01.2016	B253769	30 ditë	Batlava	Ujë për pijë		142 €			
15.01.2016	B2533768	30 ditë	Batlava	Ujë për pijë		42 €			
08.01.2016	DPR - 16303	30 ditë	KESCO	Furnizim me energji elektrike		2,009 €			
05.01.2016	0 01	30 ditë	ART HOUSE	Fotokopje me qira		1,564 €			
06.01.2016	2016/0016	30 ditë	Rrota	Mirëmbajtje e TI		80 €			
05.01.2016	K00018	30 ditë	MSS	Mirëmbajtje e objektit		1,102 €			
Totali:							8,235 €		

Detyrimet kontingjente

Natyra e detyrimeve kontingjente	2015		2014		2013	
	Shënim	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Qiraja		15.1	10	10	10	10
Pagë		15.2	11			
Totali			21	10	10	10
Shënim:						

15.1 Shuma e prezantuar është një llogaritje e kompensimit eventual për riparime të ish-zyrës sonë që mund të kërkohej nga pronari në bazë të padisë.

15.2. Shuma e prezantuar është një përlogaritje e kompensimit eventual për pagë refuzuar vendimit të KPMSHC.

16.a) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (me vlerë mbi 1000€)

Klasifikimi i pasurive	Shënim	Vlera neto - 2015	Vlera neto - 2014	Vlera neto - 2013
		€ '000	€ '000	€ '000
Veturat		-	-	-
Pajisje të TI-së		24	35	63
Pasuritë e tjera		4	7	11
Pasuritë fikse të paprekshme		12	27	10
Totali	16a.1	40	69	84

Shënim:

16a.1 Gjatë vitit 2015 nuk ka pasur blerje të reja në këtë kod (shih shënimin shpjegues 6), në mungesë të buxhetit të aprovuar në kategorinë e Investimeve kapitale. Dallimi në vlerën neto është si rezultat i amortizimit vjetor të saj.

16.b) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (me vlerë nën 1000€)	Shënim	Vlera neto 2015	Vlera neto 2014	Vlera historike 2013
		€ '000	€ '000	€ '000
Pasuria nën 1000€		76	97	101
Totali	16b.1	76	97	101

Shënim:

16b.1 Blerjet e reja në vitin 2015, në këtë kod arrijnë vlerën 16,536€. Diferenca paraqet vlerën e amortizimit vjetor.

16.c) Përmbledhje e stoqeve në fund të periudhës	Shënim	Vlera historike 2015	Vlera historike 2014	Vlera historike 2013
		€ '000	€ '000	€ '000
Klasifikimi i pasurive				
Material shpenzues		15	12	15
Derivate për ngrohjen qendrore dhe gjenerator		1	4	5
Totali:		16	15	20

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale e buxhetit

Kategoria e ndarjes	Shëni m	Përshtatjet e Autorizuara nga LMFP						Ndarjet finale të buxhetit SIMFK	Ndryshimet e buxhetit fillestar
		Ndarja Fillestare Buxhetore (ligji i buxhetit)	Ndryshimi sipas nenit 29,Ligji nr.03/L- 048	Ndryshimi sipas nenit 30,Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi për burimet e tjera të financimit	Ndryshimet për grantet e përcaktuara te donatorëve			
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000		
		a	b	c	e		f	(f-a)/f	
Hyrjet									
Donacionet	18.1					105	105	100.0%	
Të hyra të tjera	18.2				11		11	100.0%	
					11	105	116	100.0%	
Daljet(buxheti)									
Pagat dhe mëditjet	18.3	1,574	2	37			1,613	2.4%	
Mallrat dhe shërbimet	18.4	605	-54	-23		66	594	-1.8%	
Shërbimet komunale	18.5	34	0	-7		0	27	-27.5%	
Transferet dhe subvencionet		0	0			0	-	0.0%	
Shpenzimet Kapitale		0	0			0	-	0.0%	
Tjera						0		0.0%	
Totali		2213	-52	7	0	66	2,234	0.9%	

Shënime:

18.1. Shih shënimin shpjegues nr. 7

18.2. Shih shënimin shpjegues nr. 8

18.3. Shih shënimin shpjegues nr. 9

18.4. Shih shënimin shpjegues nr. 10

18.5. Shih shënimin shpjegues nr. 11

Numri i punëtorëve (Neni 19)

12

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit 05/L-001	Numri aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2015	Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2015
TOTALI	146*	147**	150***
Stafi (Auditor & Mbështetës)	(118 & 28)	(119 & 28)	(121 & 28)

Shënim

* Numri aktual i kufirit të punëtorëve është 146.

** Numri aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2015 është 147, për shkak të faktit se katër (4) zëvendësues janë angazhuar si nëpunës civil të jo-karrierës për zëvendësim të stafit në pushim të lehonisë. Ky numër i punëtorëve nuk përfshin Auditorin e Përgjithshëm dhe U.D. Drejtorin e Përgjithshëm. Auditori i Përgjithshëm pritet të emërohet nga Kuvendi. Pozita e Drejtorit të Përgjithshëm rregullohet me ligjin e zi që do të miratohet në Kuvend. Aktualisht ky post mbulohet përmes linjës buxhetore për Mallra dhe Shërbime për shkak të nevojës që kjo pozitë të jetë funksionale.

*** Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2015 është 150, duke përfshirë edhe katër (4) zëvendësues që janë pranuar për zëvendësim të stafit në pushim të lehonisë. Në këtë numër të punëtorëve nuk është përfshirë Auditori i Përgjithshëm dhe U.D. Drejtorin e Përgjithshëm.

Raporti për veprimet e ndërmarrta dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të pavarur (Neni 20)

Firma private e auditimit Deloitte Kosova, e përzgjedhur nga Kuvendi ka kryer auditimin e Pasqyrave tona Vjetore Financiare për vitin 2014. Është dhënë Opinionin e paktifikuar.

Tabela më poshtë paraqet rekomandimet e dhëna (Letrën e menaxhmentit) në lidhje me disa mangësi të vogla në MPK:

Nr.	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose i propozuar	Afat i zbatimit	Efekt
1	Në dy raste deklarata e nevojave dhe disponueshmëria e mjeteve nuk është plotësuar sipas Nenit 09 të Ligjit 04/L-042.	Rekomandimi i dhënë është marrë në konsideratë.	E finalizuar	Trajtim më i mirë administrativ
2	Akt emërimet nuk përmbajnë gradat sipas Rregullores 07/2010 për Emërimet e shërbyesve civil	E njëjta gjetje është dhënë edhe vitin e kaluar. Ligji për Pagat e Shërbyesve Civil, respektivisht Rregullorja për grada nuk ka filluar të implementohet. Momentalisht MAP ka draftuar ligjin e ri për pagat i cili është në pritje të maratimit nga Kuvendi. Veç kësaj të gjitha akt emërimet përmbajnë koeficientët.	E finalizuar	E pa-zbatueshme. Pas që Ligji aktual për Pagat e nëpunëve Civil në Republikën e Kosovës nuk ka arritë të funksionalizohet, dhe si pasojë gradat nuk janë vendosur ende.
3	Trajtimi jo i duhur i shpenzimeve të telefonisë mobile	Në këtë çështje nuk kemi gjetur mbështetjen nga MF/Divizioni i Listë-pagesave për të realizuar ndalesat e shpenzimeve të tejkaluara të telefonisë mobile nga paga neto si shkak i kufizimeve në sistemin aktual të pagesave ku ndalesat mund të bëhen vetëm në pagën bruto.	Në vazhdim	
4	Në një rast raport i vlerësimit nuk është nënshkruar nga zyrtari i Prokurimit	Gabim teknik dhe është korrigjuar.	E finalizuar	Trajtim më i mirë administrativ
5	Dosje të pakompletuara të personelit	Numëri i konsiderueshem i dokumenteve për personelin tonë janë të ruajtura në formën elektronike, në intranet në të cilin softuer kanë gjasë i gjithë stafi i Zyrës sonë. Dokumentet e vëna në dosje janë të mjaftueshme për një anëtar stafi.	Në proces	
6	Faturat nuk protokolohehen bazuar në Rregulloren financiare Nr.01/2013 - Shpenzimi i parasë publike	Nga 01.01.2015 të gjitha faturat janë duke u regjistruar/protokoluar në Ubrin e Faturave, bazuar në nenin 24.1 të Rregullës Financiare nr. 01/2013.	E finalizuar	Trajtim më i mirë administrativ
7	Prezantimi i gabuar i shënimeve tek "Barazimi i ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit", në formatin e Pasqyrave Financiare	Rekomandimi i dhënë është marrë në konsideratë dhe është përmirësuar ky gabim teknik.	E finalizuar	Trajtim më i mirë administrativ



Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 1B
10 000 Prishtina
Kosovo

T +381 38 247 771
T +381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.granthornton-ks.com

Për Auditorin e Përgjithshëm

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (më tej referuar si "Organizata" ose "ZKA"), që përfshinë Pasqyrën e Pranimit të Parave dhe Pagesave, Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2015, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 011-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin Nr. 041/L-194 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet Nr. 03/L-221 dhe Nr. 04/L-116 të cilët përcaktojnë që pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme. Kjo përgjegjësi përfshin: dizajnimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontroleve të brendshme që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë gabime materiale për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion në këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimet e rrezikut për gabimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në arkitjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të organizatës në mënyrë që të përcaktoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo edhe për qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitetin e kontrollit të brendshëm të organizatës. Auditimi po ashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël që behen nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, Pasqyra e Pranimet të Parave dhe Pagesave dhe Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (në vitin 2014 Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm) për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2014 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra më 03 korrik 2015.

GRANT THORNTON LLC
Grant Thornton LLC

Prishtinë, Kosovë
15 korrik 2016

Për informata të mëtejshme, ju lutem kontaktoni:
Za vise informacija molimo vas kontaktiranje:
For further information, please contact:

Qëndresa Mulaj
qendresa.mulaj@oagks.org
+381 (38) 60 60 04 10 12

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
Rr. "Musine Kokalari" nr. 87
10 000 Prishtinë, Kosovë
[www. oag-rks.org](http://www.oag-rks.org)